



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.05.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.¹

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 14:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Markelian Koça | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹ Z. Rusi drejton vetëm pikën e parë të rendit të ditës. Më tej mbledhja drejtohet nga znj. Llagami.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në trajtimin e pikës së parë të rendit të ditës Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
6. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice.*
7. {...}, *Inspektore jomagjistrate pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në sallë).*
8. {...}, *Këshilltare për komunikimin dhe median në Kabinetin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
9. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
10. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen e datës 02.05.2024, ora 11:00.

Ju bëj me dije që Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, për arsye objektive e ka të pamundur të jetë prezent në këtë mbledhje. Gjithashtu edhe zonja Emona Muçi, për arsye shëndetësore nuk mund të jetë në këtë mbledhje.

Sipas rendit të ditës, pika e parë e tij është zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Ftoj administratën të bëjë njoftimin e palëve për të qenë prezent në mbledhje.

(Hyn në sallën e mbledhjes znj. {...}, përfaqësuese e ILD-së.)

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Me autorizimin nr. {...}, datë 30.04.2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka autorizuar znj. {...} me detyrë inspektore pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që të përfaqësojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në procedimin disiplinor të filluar ndaj magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Prezent zonja {...}.

Ndërkohë që zonja {...} është njoftuar, por nëpërmjet e-mailit të datës 01.05.2024 ka njoftuar që: “Kam marrë dijeni që në datë 02.05.2024, ora 11:00 zhvillohet seanca për marrjen në shqyrtim kërkesën e ILD-së ndaj meje. Për arsye shëndetësore nuk mund të paraqitem dhe kërkoj shtyrje të seancës për një ditë tjetër.”, - dhe bashkëngjitur ka paraqitur raportin mjekësor nëpërmjet të cilit shprehet paaftësia e saj për punë nga data 01.05.2024 dhe është e aftë në punë në datë 04.05.2024.

Ftoj përfaqësuesen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të shprehur opinionin e saj në lidhje me këtë mungesë subjektive/objektive të saj.

{...}: Gjatë procesit të hetimit disiplinor, magjistratja {...} ka qenë korrekte me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Ka kthyer përgjigje dhe konfirmimet përkatëse. Duke qenë që ka paraqitur një raport mjeko-ligjor, kërkojmë nga ana juaj shtyrjen e seancës.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Mund të largohesh, me qëllim që Këshilli të diskutojë në lidhje me kërkesën e zonjës {...} dhe me pretendimet tuaja.

(Largohet nga salla e mbledhjes znj. {...}, përfaqësuese e ILD-së.)

Ilir Rusi: Në vijim, zonja {...}, sikundër u bë me dije, ka paraqitur raport për paaftësi të përkohshme të saj nga data 1 dhe është e aftë për punë nga data 04.05. Njëkohësisht u bë me dije edhe mbi qëndrimin e përfaqësuese së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që për shkak të kësaj arsyeje të shtyhet seanca dëgjimore.

Ftoj anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor nëse kanë propozime në lidhje me vijimin e këtij procedimi disiplinor?

Ilir Rusi: Atëherë jemi në situatën që zonja {...} nuk u paraqit për shkak të raportit dhe përfaqësuesja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kërkoi shtyrjen. Atëherë meqenëse deri tani nuk ka propozime të tjera apo diskutime, në eventualitet të miratimit të shtyrjes, do të propozoja që seanca dëgjimore e radhës të ishte në datë 16 maj, ora 11:00.

Ka diskutime?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e shtyrjes dhe të caktimit të seancës së radhës dëgjimore, që do të jetë data 16 maj, ora 11:00.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Ftoj administratën të njoftojë përfaqësuesen e Inspektorit për t'i komunikuar vendimin për ekonomi kohe.

(Rihyn në sallën e mbledhjes znj. {...}, përfaqësuese e ILD-së.)

Ilir Rusi: Referuar raportit mjekësor të paraqitur nga zonja {...} dhe qëndrimin të mbajtur nga përfaqësuesja e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, votimit të bërë nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendosëm shtyrjen e kësaj seance dëgjimore për më datë 16 maj, ditë e enjte, ora 11:00.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

(Largohet nga salla e mbledhjes znj. {...}, përfaqësuese e ILD-së.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.05.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...} për periudhën e vlerësimit 10.02.2020-21.11.2022”, relatores znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.²

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 14:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

² Zonja Llagami futet në sallën e mbledhjes në fillim të trajtimit të kësaj çështjeje dhe vijon drejtimin e mbledhjes.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Shënim 2: Nuk mori pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Markelian Koça*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
6. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice.*
7. *Sidorela Driçi, Universiteti i Tiranës.*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...} për periudhën e vlerësimit 10.02.2020-21.11.2022”, relatore znj. Irena Plaku.

Ilir Rusi: Në vijim të kësaj mbledhjeje, vazhdojmë me pikën 2 të saj që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...} për periudhën e vlerësimit 10.02.2020-21.11.2022”, për të cilën është përgatitur materiali nga relatorja znj. Plaku. Njëkohësisht në lidhje me këtë material ka paraqitur kundërshtime zonja {...}. Njëkohësisht nëpërmjet e-mailit të saj: “Parashtroj se bazuar në parashikimet e nenit 16 të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të

gjqtarëve”, nga ana ime janë paraqitur kundërshtime me shkrim të cilat besoj se janë ezauruese dhe në kushtet kur nuk kam kundërshtime shtesë për të paraqitur, mendoj se pjesëmarrja ime nuk e domosdoshme në seancë [...]”. Kështu që zonja {...} nuk do jetë prezente.

Keni ndonjë diskutim deri tani?

Po zoti Koça!

Markelian Koça: I nderuar zoti Zëvendëskryetar!

Meqenëse konstatoj nga materialet që zonja {...} kandidon dhe për pozicionin 244, të vitit 2023, pozicion që përfshihet në situatat për të cilat unë kam dhënë dorëheqjen, deklaroj se bazuar në nenin 72 të ligjit 115, nuk do të marrë pjesë në votim.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Koça.

Atëherë shqyrtimi i kësaj pike do të vijojë pa prezencën e z. Koça.

(Largohet nga salla e mbledhjes z. Markelian Koça. Ndërkohë, pas disa minutash pushim futet në sallën e mbledhjes Kryetarja e Këshillit, znj. Naureda Llagami, e cila merr drejtimin e mbledhjes.)

Naureda Llagami: Atëherë, edhe një herë, ndjesë për shkëputjen.

Për shkak të një angazhimi, erdha me vonesë në mbledhjen plenare. Kështu që pa humbur kohë dëshiroj t’ia jap fjalën relatores për relatimin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}.

Irena Plaku: Faleminderit!

Po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren e komanduar {...} për periudhën e vlerësimit 10.02.2020 – 21.11.2022.

Procedura e vlerësimit të gjyqtarës ka filluar me vendimin nr. 327, datë 14.06.2023 të KLGJ-së. Më pas ka filluar procedura për administrimin e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë procedurë.

Referuar rregullores 159 të datës 05.04.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, burimet e vlerësimit përbëhen nga të dhënat personale të gjyqtarës; raporti përshkrues vjetor i punës së gjyqtarit të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor të hartuar nga komisionet përkatës, mendimi i strukturës organizative i hartuar nga Komisioni Disiplinor dhe Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit; mendimi i strukturës përgjegjëse administrative, që është nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, si dhe të dhënat e verifikimit të ankesave të paraqitura dhe vendimet përfundimtare; të dhënat për pjesëmarrjen në përfshirjen e gjyqtarit të komanduar në aktivitete trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, ku rezultojnë që gjyqtarja ka qenë në cilësinë e pjesëmarrëses në 15 aktivitete të zhvilluara gjithsej në 24 ditë trajnimi, gjatë periudhës së vlerësimit, ku një ndër temat është edhe “Roli i mentorëve në trajnimin e trajnerëve”, duke qenë se gjyqtarja, po e theksoj, ka paraqitur kundërshtime; raporti i kontrollit të plotë të deklaratave të pasurisë dhe interesave, ku rezultojnë që deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme; nuk ka kryer fshehje; nuk ka kryer deklarim të rremë; nuk gjendet në situatën e konfliktit; si dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit të komanduar në KLGJ.

Vlerësimi edhe për këtë gjyqtare do bëhet referuar katër kritereve të vlerësimit të përcaktuar në ligj.

Aftësitë profesionale. 1.A Njohuritë ligjore. 1.A.a Aftësia hulumtuese, për të identifikuar natyrën e çështjes për trajtim, ligjin e zbatueshëm.

Referuar mendimit të strukturës përgjegjëse organizative, si dhe vetëvlerësimit të gjyqtarit është arritur në konkluzionin se nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit gjyqtarja e komanduar ka aftësi shumë të mira për të shqyrtuar dhe përpunuar në mënyre tërësore burimet fizike dhe ato elektronike me qëllim mbledhjen e informacioneve të sakta ligjore, për të përcaktuar elementët faktikë të çështjes për trajtim, për të identifikuar natyrën e saj, çështjet që shtrohen për zgjidhje, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave. Sa më sipër është propozuar aftësia e saj shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin.

Referuar raportit përshkrues të punës vjetore, mendimit të strukturës përgjegjëse organizative si dhe të vetëvlerësimit të gjyqtarës, pas analizimit të të dhënave të këtyre

burimeve të vlerësimit është arritur në konkluzionin se nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Evidentohet kujdesi i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e saj lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve. Spikat aftësia për të analizuar saktë dhe në përputhje me ligjin e zbatueshëm, faktet e çështjes së trajtuara, dhe siguron lidhjen e drejtpërdrejtë midis gjetjeve të konstatuara dhe dispozitave ligjore. Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e saj është shumë e lartë, duke propozuar pikëzimin me 25 pikë.

Sa i përket treguesit 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e akteve.

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja e komanduar i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të projekt-akteve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë, jo vetëm për subjektet proceduese por edhe çdo lexues të tyre. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit në çdo nënndarje të projekt-akteve të hartuara prej saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të tij. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e saj është shumë e lartë duke propozuar pikëzimin me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e dokumenteve ligjorë.

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja i komanduar ka aftësi shumë të larta për të mbajtur një strukturë të qartë, të qëndrueshme, të mirë organizuar, në dokumentet ligjorë të hartuar/përpunuar prej saj, strukturë të cilës i përmbahet me përpikëri gjatë prezantimit të fakteve, në identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, sipas rastit. Ajo ndjek një metodologji të caktuar sipas pjesëve përbërëse të projekt-aktit, apo sipas udhëzimeve të dhëna, në funksion të orientimit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit. Gjyqtarës së komanduar nuk i është kthyer asnjë dokument ligjor nga struktura përgjegjëse organizative për shkak të gabimeve materiale apo për mospërputhje me

metodologjinë e unifikuar apo strukturën e dakordësuar më parë, sipas rastit. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e saj është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik.

Edhe për këtë tregues, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se aftësia e saj është shumë e lartë. Gjyqtarja e komanduar shfaq aftësi shumë të larta në paraqitjen e argumentit ligjor, në analizën e normës juridike, zbërthimit dhe kuptimit të saj në raport me çështjen e trajtuar. Spikat aftësia e gjyqtarës për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në lidhje me çështjen konkrete për trajtim, duke i zbërthyer ato në raport me çështjen konkrete. Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë, duke propozuar me 25 pikë.

Atëherë propozimi për kriterin e parë profesional është 100 pikë. Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit të dytë 2. Aftësitë organizative.

Konkretisht për treguesin 2.A Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë. 2.A.a Aftësia për të realizuar volumin normal të punës.

Referuar raportit përshkrues të punës, mendimit të strukturës organizative si dhe mendimin e strukturës përgjegjëse administrative, ka rezultuar se gjyqtarja e komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të realizuar volumin normal të punës që i caktohet, duke përfshirë edhe detyra të tjera të përshkruara më sipër si pjesëmarrja në grupe pune, në procese draftimit të akteve nënligjore, në procese raportimi, mbajtja dhe raportimi i të dhënave etj. Referuar sa më sipër është propozuar pikëzimi i saj me 25 pikë.

2.A.b Aftësia për të respektuar afatet ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja e komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të për respektuar afatet parashikuara në aktet nënligjore të Këshillit apo atyre të caktuara nga struktura përgjegjëse organizative dhe administrative apo sipas rastit të natyrës së punës. Nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja e ka aftësi shumë të mira për të zgjidhur dhe përfunduar në afatin e duhur kohor çështjet dhe detyrat që i janë caktuar. Për sa më sipër vlerësoj se aftësia e saj është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

2.B Efektiviteti dhe metodologjia. 2.B.a Aftësia për të përcaktuar veprimet procedurale dhe planin e punës.

Referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja e komanduar ka treguar aftësi shumë të larta për të menaxhuar në mënyre efektive kohën dhe burimet e tjera në dispozicion, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës, në raport me sasinë e punës, duke evidentuar çështjet që kanë përparësi trajtimi si dhe ato me probleme procedurale. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e saj është shumë e lartë duke e pikëzuar me 25 pikë.

2.C Rregullshmëria dhe saktësia, 2.C.a Rregullshmëria e mbajtjes së dokumentacionit.

Edhe për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka shfaqur një aftësi shumë të lartë në renditjen e akteve dhe rregullshmërisë së dokumentacionit (fizik apo elektronik) të administruar, dokumentacion që gjyqtarja e komanduar i përcjell strukturës përgjegjëse ku ajo shërben sipas rastit ose strukturave të tjera të Këshillit, në mënyrë të tillë që dokumentacioni të jetë lehtësisht i shfrytëzueshëm. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e saj është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit.

Edhe për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka treguar një aftësi shumë të lartë për të garantuar që dokumentacioni (fizik apo elektronik) i përcjellë strukturës përgjegjëse ku ai shërben apo strukturave të tjera të Këshillit, të jetë i plotë dhe t'i përkasë çështjes konkrete. Referuar sa më lart, edhe për këtë tregues vlerësohet se aftësia e saj është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësia organizative” është 100 pikë. Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit të tretë 3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale. Edhe për këtë kriter ka rezultuar aftësia e saj shumë e lartë, duke e pikëzuar në nivelin maksimal 100 pikë.

Konkretisht për sa i përket etikës në punë, referuar burimeve të vlerësimit, duke shtuar këtu edhe informacionin e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, ka rezultuar se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion. Për sa më sipër është propozuar pikëzimi me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit, duke shtuar këtu edhe informacionin e dërguar nga Inspektorati i Lartë të Drejtësisë si dhe raportin e ILDKP-së ka rezultuar se referuar burimeve të vlerësimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale, pasi rezulton se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin. Sa më sipër është propozuar pikëzimi me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit.

Nuk ka rezultuar që gjatë periudhës së komandimit gjyqtarja të ketë përdorur gjuhë diskriminuuese. Nuk ka rezultuar nga aktet që gjyqtarja e komanduar të ketë përdorur një gjuhë diskriminuuese, në mënyrë të drejtë ose të tërthortë. Për sa më sipër, rezulton se aftësia e saj është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar për përjashtim, ose të refuzuara. Nuk rezulton që gjyqtarja të ketë paraqitur gjatë kohës së komandimit heqje dorë apo është përjashtuar. Për këtë arsye është propozuar me 15 pikë.

Propozimi, siç e thamë më lart për kriterin e tretë është 100 pikë. Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për kriterin e katërt, për të cilin për disa nga treguesit gjyqtarja ka paraqitur edhe kundërshtime, të cilat unë do t'i relatoj në treguesit përkatës.

4. Aftësia profesionale dhe angazhimi profesional. Konkretisht 4.A Aftësia e komunikimit.

Nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja e komanduar në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me eprorët, gjyqtarët e tjerë të komanduar, por edhe me stafin administrativ të KLGJ-së. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 25 pikë.

Për treguesin 4.A.b Respektimi i konfidencialitetit, edhe për këtë tregues rezulton se për sa kohë që nuk ka të dhëna që mund të ndikojnë në këtë tregues, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal në ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë arsye është propozuar aftësia e saj shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, shkëmbimi i njohurive dhe i përvojës profesionale. Edhe për këtë tregues, shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 10 pikë.

4.B.b Gatishmëria dhe kontributi për të kryer detyra të tjera që i ngarkohen nga strukturat.

Referuar burimeve të vlerësimit si dhe Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë një deri dy pikë të tjera iu shtohen në vlerësim gjyqtarëve të komanduar, për të cilët nga burimet e vlerësimit rezultojnë të dhëna mbi përfshirjen në përgatitjen e produkteve. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe të dhënave burimore për gatishmërinë dhe kontributin e gjyqtarës së komanduar në kryerjen e detyrave të tjera që i janë ngarkuar nga strukturat drejtuese të Këshillit, vlerësohet se aftësia e saj është shumë e lartë, duke u pikëzuar me 5 pikë.

4.B.c Aftësia për të bashkëpunuar dhe për të reaguar me efikasitet [..].

Edhe për këtë tregues rezulton se aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë, për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 10 pikë.

4.C Gatishmëria për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja në programet e formimit vazhdues dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit dhe informacionit të marrë nga Shkolla e Magjistraturës rezulton se gjyqtarja e komanduar {...} ka qenë në cilësinë e pjesëmarrëses në 15 aktivitete të zhvilluara gjithsej në 24 ditë. Në këto aktivitete të cilat e kam cilësuar në cilësinë e pjesëmarrëses është edhe një nga trajnimet të cilat gjyqtarja ka marrë pjesë me temën "Trajnimin e trajnerëve" por ka qenë në cilësinë e pjesëmarrëses dhe jo të ekspertës. Referuar sa më sipër, referuar edhe Metodologjisë së Pikëzimit është propozuar, duke qenë se është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë, është propozuar pikëzimi me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve.

Për këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime. Provat janë paraqitur që në momentin kur është hartuar projektraporti i vlerësimit për këtë tregues, është paraqitur bashkë me vetëvlerësimin e gjyqtares. Ka depozituar, po e lexoj në fakt këtë tregues, sa kohë që gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime. Si provë magjistratja ka depozituar vendimin e Këshillit “Për caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës për periudhën 2021-2024”, ku rezulton se edhe gjyqtarja është në cilësinë e udhëheqësve, si dhe vendimin 316/2021 “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës viti akademik 2021-2022”, njoftimin e vendimit nr. 3500/3 prot, datë 26.07.2021 ku rezulton se vendimi i është njoftuar edhe gjyqtares. Këto janë vendimet e Këshillit ku është caktuar si mentoruese.

Të dy vendimet rezultojnë që i janë njoftuar magjistrates së komanduar, por nuk rezulton që t’i jetë caktuar një kandidat magjistrat për mentorim. Kjo për shkak se gjatë kësaj periudhe gjyqtarja është komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, duke mos ushtruar kështu veprimtari gjyqësore. Pra gjatë kësaj periudhe gjyqtarja e komanduar nuk ka dhënë kontributin e saj në mentorimin e magjistratëve gjatë stazhin profesional dhe nuk ka qenë në cilësinë e lehtësueses apo ekspertes në trajnimin e gjyqtarëve.

Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, me 3 pikë, për sa kohë që nuk rezulton kontributi i gjyqtares.

Gjyqtarja, për këtë tregues, siç e thamë, ka paraqitur kundërshtime, duke pretenduar faktin që ajo ka qenë në listën e gjyqtarëve që ofrojnë mentorim por ndër të tjera dhe ka dhënë mësim në vitin e parë të Shkollës së Magjistraturës, ka kërkuar që të pikëzohet me 5 pikë, duke e konsideruar pjesëmarrjen e saj në mësimdhënie për vitin e parë si trajnim i gjyqtarëve.

Megjithatë unë i qëndroj propozimit të dhënë me 3 pikë, referuar këtu edhe praktikës së mbajtur nga Këshilli më parë në disa prej projektraporteve të vlerësimit. Mund t’i përmend edhe me emra ose me inicialet. E fundit ka qenë V.V., ka qenë D.G., ka qenë A.A., edhe të tjerë, që janë vendime të 2023, 2022 (të paktën me aq sa kam parë unë raportet e mëparshme). Për këto arsye unë i qëndroj propozimit me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Edhe për këtë tregues, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime, megjithëse është pikëzuar me pikët maksimale, por ka kërkuar që t'i njihet si veprimtari ndërinstitucionale edhe fakti se ajo është angazhuar si anëtare e bordit në Shoqatën e Grave Gjyqtare. Në fakt gjyqtarja për këtë tregues është vlerësuar me pikët maksimale me 5 pikë, për sa kohë që ka rezultuar sipas vendimit 33, datë 29.09.2020 “Për miratimin e listës së pedagogëve të jashtëm, pedagogëve në dispozicion të vitit të parë dhe specialistëve të vitit të dytë në programin e formimit fillestar”, ku rezulton pedagoge në dispozicion në lëndën ‘E drejtë tregtare’. Pra ajo ka qenë e angazhuar gjatë periudhës së vlerësimit 2020-2021 si pedagoge ku ka dhënë “Të drejtën tregtare dhe e kompanive” në vitin e parë të Shkollës së Magjistraturës. Por referuar edhe praktikës, vendimmarrjeve të mëparshme të Këshillit, nuk është njohur si veprimtari ndërinstitucionale faktin që ajo ka qenë e angazhuar në bordin drejtues të Unionit të Gjyqtarëve.

Për këtë arsye, për këtë tregues gjyqtarja është pikëzuar me 5 pikë duke iu shtuar 3 pikë për shkak se ajo është angazhuar në mësimdhënie, referuar edhe Metodologjisë së Pikëzimit.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike – Nuk rezulton që gjatë periudhës së komandimit gjyqtarja të ketë publikime ligjore, për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 0 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësia personale dhe angazhimi profesional” është 93 pikë. Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Atëherë propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi është si më poshtë:

Aftësia profesionale, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësia organizative, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale është 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësia personale dhe angazhimi profesional është 93 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e përgjithshëm është 393 pikë. Niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Janë cituar edhe rekomandimet për angazhimin e saj në veprimtari në trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore.

Shkurtimisht ju relatova edhe kundërshtimet e gjyqtares, të cilat ju jeni njohur pasi janë dërguar nga momenti që janë paraqitur nga gjyqtarja, janë njoftuar të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, faleminderit!

Ka ndonjë diskutim?

Po!

Alban Toro: Më duhet të pranoj që çuditërisht kur bëhet fjalë për vlerësimet e gjyqtarëve shpeshherë tërhiqem në një mekanizëm diskutimi dhe debati, duke besuar që kjo e fundit është një mjet i thjeshtë që shërben për të zgjidhur çështje komplekse. Por në rastin konkret më duhet të pranoj që punimi në fjalë është punim jashtëzakonisht profesional dhe më duhet ta përgëzoj relatoren në këtë prizëm. Nuk para përgëzoj apo jap vlerësime kaq pozitive për këto lloj punimesh.

Gjithsesi, më duhet në kuadër të debatit, të bëj dy propozime të cilët në opinionin tim suportohen edhe nga faktet apo nga aktet të cilat janë të administruara në dosjen e vlerësimit.

Propozimi i parë ka lidhje me treguesin 4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve, gjithmonë duke pasur parasysh parashikimet e metodologjisë së pikëzimit në këtë kontekst, ku përcaktohet se Këshilli konsideron vlerë të shtuar për gjyqtaren e komanduar gatishmërinë e tij për të kontribuar si ekspert lehtësues në trajnimin fillestar apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera, kontributi i gjyqtares i dhënë në programin e formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë gjatë periudhës 2020 e në vijim duhet të përfshihet në këtë tregues, jo në treguesin 4.C.c, duke shtuar pikëzimin edhe me 2 pikë, dhe për këtë shkak duhet të pikëzohet në 5 pikë. Pra propozimi është pikëzimi në 5 pikë.

Në lidhje me treguesin 4.C.c Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, angazhimet e gjyqtarës në bordin drejtues të Forumit të Grave Gjyqtare Shqiptare dhe organizimi nga ana e forumit nëpërmjet bordit të tij të një sërë aktiviteteve me fokus çështje të cilat lidhen drejtpërdrejt me përmirësimin e sistemit gjyqësor, në opinionin tim duhet të vlerësohet si një kontribut i gjyqtarës në treguesin “Pjesëmarrja në veprimtari të tjera ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë”, duke shtuar këto dhe 2 pikë të tjera. Në përfundim, ky tregues shtohet në 5 pikë.

Këtu mund të citoj një rast të ngjashëm të cilin ne e kemi votuar para ca kohësh për një gjyqtar të Gjykatës së Lartë, faktin e të qenit të tij anëtar i një shoqate gjyqtarësh.

Naureda Llagami: Po!

Irena Plaku: Atëherë, se nuk e paskemi regjistruar.

Dua të theksoj edhe një herë, sa i përket propozimeve të anëtarit Toro, gjyqtarës i është propozuar 5 pikë, domethënë pikët maksimale për treguesin veprimtaria ndërinstitucionale, duke arsyetuar, për shkak se kjo e fundit ka qenë pjesë e listës së pedagogëve dhe ka dhënë mësim në Shkollën e Magjistraturës për periudhën e vlerësimit, për vitin e parë, për lëndën “E drejta tregtare dhe e kompanive” dhe pasur parasysh edhe praktikën e mëparshme të KLGJ-së, kur kjo veprimtari mësimdhënie në vitin e parë konsiderohet si veprimtari ndërinstitucionale, referuar edhe Metodologjisë së Pikëzimit, është propozuar 5 pikë. Kështu që nuk ka më rritje 5 pikësh për këtë tregues. Megjithatë unë kam arsyetuar që ky 5 pikë propozohet vetëm për shkak të mësimdhënies dhe jo qenies anëtar bordi, pasi në të paktën katër vendimmarrje të Këshillit që janë të tanishme, 2022 e më vonë, vetëm qenia si anëtar bordi apo drejtues të një shoqate, pa pasur një kontribut të evidentuar, nuk konsiderohet veprimtari ndërinstitucionale.

Ndërsa për sa i përket propozimit të z. Toro për sa i përket treguesit “Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnimin e gjyqtarëve apo mentorimit” është e vërtetë se gjyqtarja ka qenë në listën e mentorimit por edhe në vendimmarrje të tjera të Këshillit, vetëm faktin që ka qenë në atë listë (kemi të fundit fare), nuk e kemi konsideruar kontribut, për shkak se rregullorja ka parashikuar 3 pikë (nisi me 3 pikë). Në rast se shikohet kontributi

efektiv i gjyqtarës, është propozuar 2 pikë të tjera, duke e çuar në 5 pikë. Ndërsa në rregulloren e Metodologjisë së Pikëzimit është përcaktuar që kontributi efektiv në trajnimet vazhduese, çka do të thotë në trajnimin e gjyqtarëve si ekspert dhe lehtësues, është konsideruar kontribut i gjyqtarës apo në mentorim, dhe jo dhënia e mësimdhënies në vitin e parë të Shkollës së Magjistraturës, por është e gjyqtarëve dhe mentorimi i kandidatëve për gjyqtarë. Mentorimi është në vitin e tretë në fakt, i kandidatëve, jo viti i parë. Nuk konsiderohet mentorim viti i parë, por është mësimdhënie, janë pjesë e programit të Shkollës së Magjistraturës që ka lidhje me mësimdhënien, që është mësimdhënia dhe është në veprimtari ndërinstitucionale. Kështu që unë i qëndroj propozimit për sa kohë që janë të njëjtat prova që janë paraqitur edhe më parë dhe referuar edhe praktikës së KLGj-së në disa vlerësime të gjyqtarëve. Më shumë se 5 po njëherë.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim tjetër?

Atëherë, nëse nuk kemi, do të propozoja që të hedhim në votim njëherë propozimin e zotit Toro.

Atëherë edhe një herë për ta përmbledhur, sikurse tha relatorja edhe z. Toro, Këshilli ka pas një praktikë që e ka konsideruar, ndërkohë në vijimësinë e tij ka pas 5 praktika, dhe më shumë, që nuk i ka konsideruar. Pra zhvillimi i praktikës së Këshillit ka qenë në një qasje tjetër. Kështu që kalojmë në votim propozimin e z. Toro për t'ia konsideruar.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Yllka Rupa: Unë jam pjesërisht dakord me propozimin e z. Toro duke marrë në konsideratë thjesht kontributin e qenies pjesë të një cikli trajnimesh për trajnerë me temë

“Lirinë e shprehjes”. Në këto kushte propozoj ngritjen me 2 pikë lidhur me këtë komponent.

Naureda Llagami: Atëherë, edhe një herë se kemi dy qëndrime të ndryshme.

Yllka, të lutem, propozimin tënd do ta bësh më vete.

Jemi tek propozimi i Albanit. Jep votën për propozimin e Albanit dhe më pas nxirr argumentin.

(Zonja Rupa sqarohet pa ndezur mikrofonin.)

Edhe një herë, Alban do të thuash propozimin e parë. Ta themi, se nuk e ka kuptuar Yllka.

Çfarë ke kuptuar?

Yllka Rupa: Ta sqaroj edhe një herë?

Pro, me 2 pikë, duke marrë në konsideratë trajnimin.

Naureda Llagami: Atëherë, edhe një herë ripërsëritet votimi sepse ka paqartësi për çfarë votohet.

Zoti Toro të lutem edhe një herë fjalën, propozimin konkret për kë pikë dhe më pas të votojë gjithsecili.

Alban Toro: Nuk e kuptoj pse është kaq e komplikuar ndërkohë që është shumë e qartë.

Në lidhje me treguesin Acb. (4.C.b) Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve, duke pasur në konsideratë parashikimet e metodologjisë të pikëzimit sipas të cilës Këshilli konsideron vlerë të shtuar për gjyqtaren e komanduar gatishmërinë e tij për të kontribuar si ekspert lehtësues në trajnimin fillestar apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera. Kontributi i gjyqtares i dhënë në programin e formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë gjatë periudhës 2020 e në vijim duhet të përfshihet në këtë tregues, dhe jo në treguesin 4.C.c. Më kuptove? Me këtë arsyetim, duke shtuar pikëzimin edhe me 2 pikë, pra nga 3 dhe 2, bëjnë 5.

Irena Plaku: Më fal, Albani kërkon që t'i ngrihen 2 pikë të tjera tek kontributi i gjyqtarit në trajnimin e gjyqtarëve dhe mentorim, duke konsideruar si vlerë të shtuar faktin që gjyqtarja ka dhënë mësim në vitin e parë të magjistraturës. Apo jo Alban?

Po! Ky është propozimi. Dhe propozon rritjen nga 3 me 2 pikë për shkak se gjyqtarja ka dhënë mësim në vitin e parë të Shkollës së Magjistraturës dhe jo për faktin se ka qenë eksperte lehtësuese apo mentorim. Por kërkon që mësimdhënia të mos i kategorizohet tek kontributi në veprimtari ndërinstitucionale por tek kontributi i gjyqtarës në trajnimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Aty i kemi dhënë 3 pikë. Ndërsa atë unë kam propozuar 5, thotë ta kalojmë këtu, mos e kategorizojmë atje.

Ridvan Hado: Atëherë, mund ta sqaroj unë?

Naureda Llagami: Atëherë, edhe një herë për ta sqaruar.

Alban Toro: Më fal, Naureda, Yllka shton 2 pikë, por ka një arsyetim të ndryshëm nga Albani.

Naureda Llagami: Edhe ti në thelb nuk ndryshon pikët, ti thjesht i kategorizon pikët nga kjo këtu, tek kjo këtu.

Ajo që ne diskutojmë tani është që, kemi 4.C.c. Pjesëmarrja në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë. Këtu Alban relatorja i ka dhënë 5 pikë (maksimalet). Atëherë, ti ke mendimin që ky 5-pikëshi këtu nuk duhet këtu, thua ti. Ti thua, tek 4.C.c., 5-pikëshi që është propozuar nga relatorja, nuk duhet të jetë me arsyetimin e relatores. Asnjëri nga ne s'e kishte kuptuar këtë. Prandaj duhet sqaruar. Kalojmë në votim këtë gjë njëherë. Albani thotë që 5-pikëshi i relatores nuk duhet të merret për shkak të mësimdhënies por për shkak të anëtares së bordit. Kaq. Hedhim në votim propozimin e arsyetimit të Albanit, a duhet 5-pikëshi të llogaritet, Albani thotë duhet të jetë si anëtare e bordit, jo si shkak i trajnimeve.

Ilir Rusi: Nuk kam shumë qejf të bëj komente kur votoj, por në raport me vlerësimin, unë vlerësoj pikët dhe kur kam votuar në një moment të kaluar u hodh në

votim 4.C.c. dhe kam votuar në raport me vlerësimin në pikë. Vlerësimi në pikë ka qenë 5 dhe kam qenë dakord me vlerësimin 5.

Tashmë po hidhet në votim argumenti i përdorur përse ky vlerësim është 5 në raport me dokumentet e paraqitura. Jam kundër propozimit të bërë nga zoti Toro.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër sepse ky është qëndrimi i mëparshëm që kam mbajtur në të gjithë vlerësimet e gjyqtarëve të tjerë.

Yllka Rupa: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet me shumicë votash kundër.)

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozimi i dytë.

Zoti Toro, propozimi i dytë. (*ripërsëritet*)

Alban Toro: Në lidhje me treguesin 4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit të komanduar për trajnimin e gjyqtarëve, duke pasur në konsideratë parashikimet e metodologjisë së pikëzimit sipas së cilës Këshilli konsideron vlerë të shtuar për gjyqtarin e komanduar gatishmërinë e tij për të kontribuar si ekspert lehtësues në trajnimin fillestar apo në trajnime të organizuara nga institucione të tjera, kontributi i gjyqtarës i dhënë në programin e formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë gjatë periudhës 2020 e në vijim duhet të përfshihet në këtë tregues, jo në treguesin 4.C.c, kam thënë, duke shtuar pikëzimin edhe me 2 pikë, për këtë shkak, në total bëhen 5 pikë.

Naureda Llagami: Pra ju sugjeroni që tek treguesi 4.C.b të shtohet 2 pikë.

Megjithatë e hedhim edhe një herë në votim meqë është propozim... Vazhdo!

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër vetëm me një argumentim. Ajo çfarë thotë Albani është vlerësuar tek treguesi i radhës, 4.C.c., është e vlerësuar dhe është bërë 5 pikë aty. Ai është kontribut i njohur, trajnimi i magistratëve në vitin e parë.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet me shumicë votash kundër.)

Yllka Rupa: Duke marrë në konsideratë edhe kundërshtimet që ka bërë gjyqtarja, pra zonja {...}, pretendon që në lidhje me treguesin disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe trajnimin e gjyqtarëve, t'i merret në konsideratë edhe kontributi i qenies pjesë i një cikli trajnimesh për trajnerët për lirinë e shprehjes duke u certifikuar si trajnerë në këtë fushë nga Këshilli i Evropës. Unë mendoj që në lidhje me këtë trajnim, duke u konsideruar si trajnim i organizuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe institucionet e tjera, të ngrihet në nivelin e 5 pikëve lidhur me këtë komponent, duke vlerësuar këtë trajnim.

Naureda Llagami: Relatorja?

Irena Plaku: Në fakt të gjitha trajnimet, siç kemi bërë edhe vlerësimet e të gjithë gjyqtarëve të tjerë, pjesëmarrja në këto trajnime të specializuara që bëhen për trajnerë të cilët marrin pjesë në programin e trajnimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës si trajnerë apo lehtësues, është konsideruar thjesht si pjesëmarrës. Një vërtetim të tillë, me të njëjtën përmbajtje, e ka sjellë edhe vetë Shkolla e Magjistraturës. Fakti që ky trajnim është organizuar dhe nga institucione të tjera ndërkombëtare nuk përbën asnjë vlerë të shtuar, pasi edhe më parë ne kemi pasur gjyqtarë të cilët kanë marrë pjesë në trajnime të kryer edhe jashtë shtetit, nuk e kemi quajtur vlerë të shtuar sepse metodologjia thotë: Pjesëmarrja në trajnimin e Shkollës së Magjistraturës apo në trajnime të tjera të

organizuar nga institucione të tjera të cilat mund të jenë edhe ndërkombëtare, mund të jenë zhvilluar edhe jashtë shtetit, për shembull kemi pasur gjyqtarë të cilët kërkuar trajnime në Holandë, në Austri, sepse është pjesëmarrje, duhet të jetë kontribut i evidentuar. Se për shembull kur gjyqtarja shkon si ekspert ose lehtësuese, çon edhe një material, bën edhe një trajnim tjetër.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim propozimin e Yllkës.

Ilir Rusi: Kundër.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër për shkak të qëndrimit tim të mëparshëm për të tilla çështje.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër këtij propozimi, duke iu referuar fakteve që janë paraqitur, provave, të shqyrtuara dhe të diskutuara këtu së bashku. Nëse gjyqtarja do ishte në pozicionin e trajneres (se duhet ta specifikojmë dhe ta qartësojmë këtë situatën), pra trajneres ose ekspertes, atëherë do dakordësohesha me propozimin dhe unë do isha gati që t'i shtonim edhe 2 pikë të tjera. Me vërtetimin që ka sjellë Shkolla e Magjistraturës por edhe me shpjegimet që ka dhënë magjistratja, konstatoj që në këtë trajnim ajo ka qenë në pozicionin e pjesëmarrëses dhe ka marrë certifikatë si pjesëmarrëse në këtë trajnim. Duke qenë në pozicionin e pjesëmarrëses ajo nuk ka dhënë kontribute siç e kërkon pika 4.C.b pra disponueshmëria e gjyqtarit për trajnimin e gjyqtarëve. Në këtë rast ajo nuk ka trajnuar gjyqtarë por është e trajnuar si trajnere. Faleminderit! Prandaj them që jam kundër këtij propozimi.

Naureda Llagami: Kundër.

(Nuk miratohet me shumicën e votave kundër.)

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë në tërësi raportin e relatores sipas propozimit të saj. Kalon në tërësi raporti meqë propozimet mbaruan.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Pjesërisht dakord.

Alban Toro: Pjesërisht dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtares së komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor znj. {...}, me nivel të përgjithshëm të vlerësimit "Shkëlqyeshëm" dhe me nivel total pikësh 393 pikë.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.05.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për kërkesën e z. {...} për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro). (Çështje e shtyrë nga mbledhja plenare e datës 21.09.2023).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 14:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Markelian Koça*** (anëtar)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

26

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 02.05.2024 (Pika 3)***

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte pranë EWWMI/INL.*
6. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për kërkesën e z. {...} për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro). (Çështje e shtyrë nga mbledhja plenare e datës 21.09.2023).

Naureda Llagami: Atëherë sa të vijë dhe zoti Koça.

(Hyn në sallën e mbledhjes z. Markelian Koça.)

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja e radhës që ka të bëjë mbi kërkesën e z. {...} për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Kjo është një kërkesë të cilën ai ia ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për më shumë detaje, ia jap zotit Toro, të cilën në mbledhjen e parë ne e kemi shqyrtuar por e kemi shtyrë për të marrë një informacion më të detajuar nga Kuvendi, që ka të bëjë me relacionin në miratimin e paketës ligjore që përfshihet në këtë çështje.

27

Për më shumë detaje fjalën ia jap z. Toro.

Alban Toro: Për retrospektivë më duhet të kërkoj durimin tuaj pasi në këtë procedurë relativisht do të jem i detyruar të bëj prezent pretendimet që ka kandidati apo aplikanti në raport me kërkesën e tij, por njëkohësisht të bëj edhe një retrospektivë në lidhje me shkaqet të cilat ne jemi detyruar ta shtyjmë seancën e fundit e cila u shty për shkak sepse një nga anëtarët e Këshillit kërkoi që të disponohej vullneti i Kuvendit në ndryshimet që i ka bërë ligjit 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

Nga ana e Kuvendit është vënë në dispozicion relacioni për projektligjin “Për shtesa dhe ndryshime në ligjin 8577 datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, të ndryshuar””. Një kopje të tij e dispononi të gjithë. Nëse do duhet ta lexoj, më orientoni. Gjithsesi, të paktën, po mundohem në mënyrë të sintetizuar të bëj prezent disa nga konkluzionet që ka ky projektrelacion i bërë në kontekstin e ndryshimit të ligjit 8577, më konkretisht:

“Shtesa dhe ndryshime në ligjin 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, të ndryshuar”” kanë si qëllim thjeshtëzimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe për të garantuar funksionimin e plotë dhe normal të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu përmes këtyre ndryshimeve synohet që ky ligj të harmonizohet me ligjet e tjera të paketës së reformës në drejtësi, veçanërisht sa i takon shumicës së nevojshme për të pasur një mbledhje të vlefshme të gjyqtarëve nëpër gjykata përfshirë edhe Gjykatën e Lartë.

Nga ana tjetër, ndërmarrja e kësaj nisme ka si objektiv dhe nxitjen për kandidimin e kandidatëve më të mirë të mundshëm që vijnë nga radhët e magjistratëve. Ky objektiv synohet të arrihet nëpërmjet njohjes së të drejtës së tyre për t’u caktuar si gjyqtar ose prokuror të paktën në nivel apeli në përfundim të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese. Ndërmjet këtyre ndryshimeve krijohen kushtet për zgjedhjen e të gjithë anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese duke garantuar funksionimin e rregullt të saj si dhe një nga kushtet kyçe të Bashkimit Evropian për mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare me Shqipërinë.

Projektligji nuk është parashikuar në programin analitik të akteve por lidhet drejtpërdrejt me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe dokumente të tjera politike pasi reforma në drejtësi dhe funksionimi i një sistemi drejtësie i cili garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në tërësi përbën prioritet të një rëndësie të veçantë të Këshillit të Ministrave dhe të shoqërisë shqiptare në përgjithësi.

Në parashikimet aktuale të ligjit në nenet 7/b dhe 7/c përcaktohet procedura e emërimit të gjyqtarit përkatësisht nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi. Në këto dispozita parashikohet që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi pas vlerësimit të kushteve dhe të kriterëve të emërimit, të hartojë një listë përfundimtare duke renditur kandidatët. Nëse ka më shumë se një vend vakant, Këshilli harton dy lista të veçanta, një prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit.

Ky parashikim nuk gjen mbështetje në dispozitat kushtetuese të cilat nuk parashikojnë lista të veçanta, por për çdo vakancë dëgjohet lista e të gjithë kandidatëve që kanë aplikuar për atë vakancë, pavarësisht nëse vijnë nga radhët e gjyqësorit apo jo. Po ashtu, këto dispozita nuk kanë gjetur as zbatim në praktikë si dhe janë kundërshtuar edhe nga Komisioni i Venecias, i cili nuk i ka gjetur në përqasje me kushtetutën.

Me shfuqizimin e fjalisë “nëse ka më shumë se një vend vakant, Këshilli harton dy lista të veçanta, një prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit”, garantohet edhe që: në momentin e emërimit të kandidatit, organet e emërtesës të kenë detyrimin të marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve; ndërmjet hartimit të një liste unike dhe emërimit të kandidatëve nga kjo listë, sigurohet emërimi i atyre kandidatëve të cilët plotësojnë më së miri kriteret për të qenë pjesë e Gjykatës Kushtetuese duke garantuar emërimin e figurave me integritetin dhe përgatitjen më të lartë profesionale, pavarësisht nëse vijnë nga radhët e gjyqësorit ose jo.

Në procedurën e zgjedhjes së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese nga Gjykata e Lartë, përmes dispozitës së parashikuar në projektligj është ndryshuar kuorumi i nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes nga tre të katërtat, në jo më pak se gjysmën e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, por duke ruajtur gjithsesi shumicën e kërkuar nga ligji. Ky rregull do të jetë në fuqi derisa Gjykata e Lartë të ketë të paktën tre të katërtën e të gjithë anëtarëve të saj, por në çdo rast, jo më vonë se data 31.12.2023.

Kjo ndërhyrje vjen në linjë me ndryshimet e ligjeve të tjera të paketës në drejtësi që lidhen me vlefshmërinë e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve. Në ligjin 98/2016 është parashikuar që në nenin 29, pika 1, pas fjalisë së parë, të shtohen fjalitë me këtë përmbajtje: “Në mbledhje marrin pjesë të gjithë gjyqtarët që ushtrojnë detyrën. Mbledhja është e vlefshme kur marrin pjesë shumica e gjyqtarëve.” Ndërkohë në nenin 26, pika 4 shtohet fjalia “Mbledhja e gjyqtarëve është e vlefshme kur marrin pjesë shumica e anëtarëve që ushtrojnë detyrën në gjykatë”. Ndërkohë në nenin 30 mbi analogjinë e dispozitave të ligjit të sipërcituara parashikohet se rregullimet e neneve 26 dhe 29 aplikohen për aq sa është e mundur edhe për Gjykatën e Lartë.

Pra kuorumi i mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të të gjitha gjykatave është ndryshuar. Në të njëjtën linjë, si një rregullim i përkohshëm, deri në funksionimin e plotë të Gjykatës së Lartë, i njëjti rregull mund të ndiqet edhe në rastet kur Gjykata e Lartë zgjedh tre anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyrë edhe kuorumi i nevojshëm për të patur një mbledhje të përgjithshme të vlefshme për zgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese duhet të jetë jo më pak se gjysma e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

Ndërkohë në nenin 18 për të drejtat e tjera të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese në pikën 3 të këtij neni, pas fjalisë së parë është parashikuar shtimi i një fjalie. Përmes kësaj shtese (kjo është e rëndësishme) synohet që t’i jepet e drejta gjyqtarit, i cili përpara emërimit të tij në Gjykatën Kushtetuese ka pasur statusin e magjistratit për t’u kthyer në sistemin e drejtësisë në një pozicion në nivel apeli në gjykata ose prokurori nëse plotëson kriteret për atë pozicion. Ky parashikim do të shërbejë si një shtysë për një numër të madh kandidatësh për të aplikuar për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, pasi ata do të kenë të drejtën të emërohen në një pozicion apeli pas mbarimit të mandatit. Ky emërim pas mbarimit të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese do të rrisë interesin e gjyqtarëve apo prokurorëve të cilët aktualisht ushtrojnë detyrën e tyre pranë gjykatave të shkallës së parë, duke e parë kandidimin e tyre për vendin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese si një mundësi edhe për zhvillimin e mëtejshëm të karrierës së tyre në planin afatgjatë.

Eventualisht do të rritet edhe numri i kandidatëve të cilët do të konkurrojnë për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese. Nga ana tjetër edhe vetë sistemi i drejtësisë

do të ketë një vlerë të shtuar duke bërë pjesë në radhët e tij një figurë me integritet të lartë profesional si një ish-gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.”

Pra ky ishte vlerësimi që ka bërë grupi i cili ka propozuar ndryshimet në ligjin për Gjykatën Kushtetuese.

Ndërkohë më lejoni të lexoj relacionin tim dhe më pas të lexoj parashtrirat që ka bërë kandidati në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës së tij.

Në Këshillin e Lartë Gjyqësor me anë të kërkesës së datës 14.04.2023, protokolluar pranë KLGJ-së me nr. 2425 prot., datë 18.04.2023, z. {...}, me funksion të fundit gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me status të përfituar të magjistratit, ka shprehur interesin për t’u caktuar gjyqtar, në një pozicion në nivel apeli referuar nenit 6, 15, 49/1, 124, 125, 138/1 të Kushtetutës, nenet 1/1, 17/3, 18/3 të ligjit nr.8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 2/gj, 62 dhe 164 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenet 41, 44, 58/1 dhe 59/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Karta Evropiane e Statusit të Gjyqtarit.

Në këtë kërkesë, nga ana e kërkuarit z. {...} theksohet... ndërkohë po e kufizoj pasqyrimin e përmbajtjes së relacionit të z. Bunaj pasi atë do duhet ta pasqyroj në mënyrë konkrete në citimin që do t’i bëj kërkesës të cilën ai ka dërguar. Kështu që po kaloj tek pjesa arsyetuese.

Nga aktet e administruara në kërkesën e përcjellë në rastin konkret jetëshkrimi, rezulton se z. {...} nga 01.08.1992 - dhjetor 1997, me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, emëruar hetues në Prokurorinë e Rrethit Vlorë. Nga data 24.12.1997, me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga 15.01.1999 - 28.01.2008, zv /Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Nga tetor 1999 - dhjetor 2000, ushtrues i detyrës së Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Vlorë. Nga 28.01.2008 - 19.03.2010, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier. Nga 25.03.2010 - 25.02.2013, Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Nga 28.05.2013 - 28.07.2016, emëruar prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga 17.03.2014 - 12.01.2015, Drejtor i drejtorisë kundër krimit ekonomik, korrupsionit dhe krimit të organizuar, në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga 28.07.2016 -

22.12.2020, transferuar me pëlqim dhe emëruar Drejtues i Prokurorisë së Apelit Vlorë. Nga data 22.12.2020 - 09.01.2023, gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.”

Relatori duke u mbështetur në dispozitat Kushtetuese si edhe ligjin specifik të zbatueshëm për çështjen në shqyrtim si edhe nga aktet shoqëruese të kërkuesit {...}, vlerëson se kërkimi i tij për t’u caktuar në detyrën e gjyqtarit të apelit pas përfundimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese është i pabazuar në ligj dhe në prova.

Në këtë konkluzion relatori ka arritur pasi ka marrë në vlerësim dispozitat Kushtetuese dhe ato ligjore me qëllim identifikimin e frymës dhe qëllimit të kushtetutëbërësit në lidhje me garancitë në nivel kushtetues të statusit të gjyqtarit i cili ruan ngjashmëri për disa elemente të tij me atë të prokurorit, por nga pikëpamja e ushtrimit të funksionit ka dallime të dukshme kjo edhe për shkak të fushës të cilën mbulojnë.

Për të kuptuar thelbin e këtij ndryshimi është e detyrueshme një analizë e detajuar e elementeve të statusit të gjyqtarit, funksionit dhe karrierës së tij.

Neni 138 i Kushtetutës përcakton elementet përbërëse të statusit të gjyqtarit, ku për të garantuar ushtrimin e pavarur të funksionit të tij janë përfshirë elemente të pagës, përfitime të tjera si edhe zhvillimi i karrierës. Ngritja e tyre në standarde kushtetuese detyron ligjvënësin të mos cenojë statusin e gjyqtarëve, të drejtat dhe përfitimet që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë. Ky status më pas u mundëson sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elemente këto që priten në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Sipas jurisprudencës kushtetuese, ligjvënësi duhet të kujdeset edhe për funksionimin sa më mirë të pushtetit gjyqësor, me qëllim realizimin e misionit që gjyqtarët kanë, pra atë të dhënies së drejtësisë. Drejtësia mund të jetë e besueshme dhe me integritet kur jepet nga gjyqtarë që nuk ngjallin dyshime për sa i takon figurës së tyre (duke cituar në këtë rast vendimin nr.34, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

Në këtë kuadër karriera, si pjesë integrale e garancive që burojnë nga neni 138 i Kushtetutës është në funksion të garantimit të pavarësisë së gjyqësorit dhe respektimi i tyre krijon njëkohësisht besimin te publiku për sa i përket pavarësisë, integritetit dhe paanshmërisë së gjyqtarëve. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin

gjqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në elementet e sipërcituar, por edhe në ruajtjen e standardeve ndërkombëtare të cilët pohojnë se kushti i nevojshëm për një gjyqësor të pavarur është që gjyqtarët të kenë sigurinë e qëndrimit në detyrë.

Parimet bazë të OKB-së parashikojnë që: 1. Mandati i gjyqtarëve, pavarësia, siguria, shpërblimi i përshtatshëm, kushtet e shërbimit, pensionet dhe mosha e pensionimit të tyre duhet të jenë mjaftueshëm të garantuara me ligj. 2. Gjyqtarët, pavarësisht nëse janë të emëruar ose të zgjedhur, duhet të kenë qëndrim të garantuar në detyrë deri në një moshë të detyrueshme pensionimi ose deri në skadimin e mandatit të tyre në detyrë, kur kjo ekziston.

Mandatet e fiksuara të detyrës dhe ruajtja e tyre edhe pas lëvizjes së përkohshëm në detyra të tjera sigurojnë garancinë e pavarësisë së tyre të përcaktuar në nenin 145/1 ku parashikohet se: “Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”.

Parimi i sigurisë juridike i sipërcituar në mënyrë të veçantë në lidhje me ruajtjen e vendit të punës dhe qëndrueshmërinë e saj mbron garancitë që rrjedhin nga neni 138 i Kushtetutës, dhe qëllimi i saj është të sigurojë besimin e personave të shtetit e ligji dhe vetë gjyqtarët, të cilët administrojnë drejtësinë, duhet të gëzojnë një besim të tillë (edhe në këtë rast është cituar vendimi nr.11, datë 06.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

Duke iu kthyer analizës së kërkimit të z. {...} i referohemi legjislacionit që rregullon në mënyrë të posaçëm garancitë statuale të parashikuara për magjistratin mandati i të cilit përfundon në Gjykatën Kushtetuese.

Në vështrim të nenit 18/3 të ligjit nr.8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, përcaktohet se:

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet:

a) të kenë një mbrojtje të veçantë të vetes, familjes dhe pronës, kur një gjë të tillë e kërkojnë vetë për rrethana serioze ose çmohet se është e domosdoshme. Organet përkatëse, të ngarkuara me ruajtjen e personaliteteve të larta, janë të detyruara t'i përgjigjen çdo kërkesë të bërë në këtë drejtim;

b) të përfitojnë leje të pagueshme vjetore 40 ditë.

c) të përfitojnë falas Fletoren Zyrtare;

ç) të përfitojnë në mënyrë të barabartë po ato të drejta që gëzojnë deputetët, sipas neneve 16 pika 1, 19, 20, 23, 25 dhe 26 të ligjit nr.8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit".

Në rastet kur përpara emërimit gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzonte statusin e magjistratit, në përfundim të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka të drejtë të caktohet të paktën në një pozicion në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose në prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në këtë dispozite përcaktohet qartë se magjistrati, gjyqtar apo prokuror, ka të drejtë të caktohet në një pozicion në nivel apeli. Dispozita ligjore ka përfshirë në terminologjinë e saj nocionin "magjistrati". Në sistemin ligjor civil të vendeve të Evropës kontinentale, të tilla si Franca, Italia dhe Shqipëria, magjistrat është një term i përgjithshëm që përfshin Prokurorët dhe Gjyqtarët. Emri magjistrat buron nga termi i vjetër francez "magjistrat", i cili rrjedh nga fjala latine magistratus, dhe që buron nga fjala magister (mjeshtër), e përberë nga rrënja magnus (i madh).

Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nuk ndihmon në mënyrë të posaçëm individualizimin e kategorisë së magjistratit, pasi objekti i tij është përcaktimi i statusit të magjistratëve (neni 1), term që sipas nenit 2/gj të tij i referohet gjyqtarit (me përjashtim të atij të Gjykatës Kushtetuese), prokurorit dhe kryetarit të gjykatës ose të prokurorisë, përfshirë kryetarin e Gjykatës së Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme. Ky ligj i referohen magjistratit profesionist pa bërë asnjë dallim midis gjyqtarit dhe prokurorit për rrjedhim analiza e tij do të bëhet duke u mbështetur në dispozitat ligjore që rregullojnë fushën e aktivitetit specifik të tij, në bazë të së cilit konstatohen dallime të posaçme.

Kërkuesi detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese e ka filluar më datë 22.12.2020 në përputhje me parashikimet në nenit 125/2 dhe 129 të Kushtetutës. Përpara emërimit në këtë funksion ai kryente detyrën e Prokurorit të Apelit duke gëzuar statusin e magjistratit, prej vitit 1997.

Në nenin 148 të Kushtetutës përcaktohet se: "Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj. 2.Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen,

kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit. 3. Prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.”.

Nga dispozita e sipërcituar rezulton se Kushtetuta e ka veshur prokurorin me kompetenca për të ushtruar ndjekjen penale, si dhe për të përfaqësuar akuzën në gjyq në emër të shtetit, për të garantuar një sistem të një drejtësie penale funksionale, kundër çdo akti që përbën kërcënim për shtetin e së drejtës dhe rendin kushtetues. Sipas nenit 148/ç të Kushtetutës i cili parashikon se:

“1. Prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë, që emërohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.

2. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e prokurorëve parashikohen me ligj”, një shtetas shqiptar mund të emërohej prokuror vetëm pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak” .

Organi kompetent, sipas kësaj norme Kushtetuese për emërimin e prokurorëve, është Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Ndërkohë nocioni/etimologjia gjyqtar rrjedh nga fjala latine iudex, e përberë nga fjala “ius”, “e drejta”, dhe “dicere”, “flas, shpall”, duke përfaqësuar individin që kryeson procedurat gjyqësore, qoftë i vetëm ose si pjesë e një trupi gjykues. Si deklarues mekanik të ligjit, por duke bërë interpretim të kujdesshëm të tij, në konformitet me frymën e ligjit dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ata zgjidhin konfliktet nëpërmjet vendimeve përkatëse.

Neni 136/ a i Kushtetutës, (Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016) përcakton se: 1. Gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit. 2. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve parashikohen me ligj.

Nga analiza e dispozitave respektive rezulton qartë se fusha e aktivitetit të magjistratit, gjyqtar dhe prokuror janë të ndryshme jo vetëm për shkak të formimit/profilizimit, funksionit specifik që ata luajnë në shtetin e së drejtës, por edhe

Institucioneve që merren me emërimin dhe shkarkimin e tyre (në këtë rast Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor).

Me individualizimin e funksionit të tyre rezulton qartë edhe përfitimet që rrjedhin nga garancitë statuale përkatëse për çdo profesion. Referuar analizës gjuhësore dhe logjike të dispozitës të parashikuar nga neni 18/3 i ligjit 45/2021 ku përcaktohet se “Në rastet kur përpara emërimit gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzonte statusin e magjistratit, në përfundim të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka të drejtë të caktohet të paktën në një pozicion në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose në prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, rrjedh se të dy kategoritë që përbëjnë magjistratët mbrohen nga garancitë kushtetuese të lidhur me statusin e tyre duke përfshirë emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra, (pa shkaqe të përligjura, me mos ndjekjen e tyre penalisht), si edhe në rastin konkret kur u mbaron mandati në Gjykatën Kushtetuese.

Sipas nenit 1, pika 2, të ligjit nr.96/2016, shtetasi që fiton statusin e magjistratit sipas ligjit e gëzon atë sapo emërohet në funksion dhe e përfundon me mbarimin e ushtrimit të funksionit, për ndonjë nga shkaqet e parashikuara nga dispozitat ligjore

Fakti i ruajtjes së garancisë statuale pra të emërimit “përkatësisht në gjykata ose në prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” rrjedh edhe për shkak të kontekstit historik ku kjo dispozitë iu nënshtrua ndryshimit.

Në vështrim të kontekstit historik të miratimit të ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr. 76/2016 dhe ligjit nr. 84/2016, rezulton se nevoja për miratimin e këtyre ndryshimeve dhe këtij procesi të jashtëzakonshëm kontrolli e vlerësimi për magjistratët, të dy kategoritë përbërëse të tij, kishte lindur për shkak të korrupsionit endemik të pranuar si nga faktori i brendshëm edhe i jashtëm në sistemin e drejtësisë në vend.

Procesi i rivlerësimit u miratua në frymën dhe synimin për të nxjerrë nga sistemi individë, të cilët, për shkak të nivelit të pabesueshëm në justifikimin e pasurisë, në kontrollin e figurës apo të aftësive profesionale, kishin cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ky proces u konsiderua nga kushtetutbërësi, si i vetmi dhe i justifikueshëm për të mundësuar pastrimin e radhëve të sistemit të drejtësisë por që më

pas rezultoi shkaktar i krijimit të vakancave në të gjithë sistemin gjyqësor përfshi edhe atë Kushtetues duke ndaluar/pakësuar edhe kërkesat për emërimë në këtë të fundit.

Për të nxitur kërkesa për emërimë në mënyrë të veçantë në Gjykatën Kushtetuese si edhe për t'u kujdesur edhe për funksionimin sa më mirë të pushtetit gjyqësor, me qëllim realizimin e misionit që ata kanë, pra dhënies së drejtësisë, ligjvënësi, fuqizoi garancitë statuale në rastin konkret të, ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, duke garantuar kthimin e prokurorit apo gjyqtarit pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit Kushtetues në gjyqtar apo prokuror në nivel apeli.

Në këtë kuadër, pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, ligji i garanton kërkesit kthimin e tij si prokuror në nivel apeli. Kjo pasi në nenin 13 dhe 16 të Ligji Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" përcaktohet se: "Prokuroria përbëhet nga:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroria e Posaçme;
- c) Prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm; .."

dhe "Funksionet e Prokurorisë pranë çdo gjykate apeli të juridiksionit të përgjithshëm ushtrohen nga prokurorët e apelit. Juridiksioni i tyre shtrihet në territorin e juridiksionit të gjykatës përkatëse"

Ndërkohë kërkimi i tij për t'u caktuar si gjyqtar i apelit është në kundërshtim jo vetëm me garancitë statuale të analizuara më lart, por edhe me përcaktimin e dispozitës ligjore, "...me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve".

Kriteret e kërkuara nga ligji për gjyqtarin e Gjykatës së Apelit janë përcaktuar në nenin Konkretisht, sipas nenit 47 të Ligjit nr. 96/2016 ku përcaktohet:

1. "Ngritja në detyrë" është kalimi nga:

- a) një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë; dhe këtu kam cituar të gjithë dispozitën ligjore, për të mos humbur kohë.

Nga aktet e depozituara nuk rezulton që kërkuesi të plotësojë edhe kriterin

minimal të kërkuar për gjyqtarin e juridiksionit të përgjithshëm të apelit duke shkaktuar në këtë mënyrë rrëzimin përfundimisht të kërkesës së tij.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

- Të refuzojë kërkesën z. {...} për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

- Gjithashtu në këtë projektvendim parashikohet edhe e drejta e ankimit nga ana e kërkuarit sipas ligjit.

Natyrisht që zoti {...} fillimisht ka kërkuar të jetë prezent për të bërë të ditur shkaqet që pse duhet pranuar kërkesa e tij. Më pas, me një e-mail të veçantë të datës 20.09.2023 ka refuzuar pjesëmarrjen duke e konsideruar të pamundur dhe ka konsideruar të mjaftueshëm shpjegimet e bërë me shkrim për seancën, të cilat unë jam i detyruar t'i lexoj, në mungesë të prezencës së tij në këtë seancë. Kështu që kërkoj mirëkuptimin tuaj.

“Në vijim të kërkesës së datës 14.04.2023, për fillimin nga ana e KLGJ të procedurës administrative për caktimin e subjektit tim në një pozicion të Gjykatave të Apelit, nëpërmjet këtij materiali lutem të pranoni edhe këto shpjegime të tjera mbi rrethanat, faktet dhe çështjet ligjore rreth saj.

Në kërkesën time të lartpërmendur parashtroja qëndrimin se në rastin e subjektit tim gjendeshin të plotësuara të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore, për t'u caktuar në një pozicion të nivelit të Gjykatave të Apelit, sipas nenit 18/3 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe nenit 62 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

Në vijim të kësaj procedure administrative, përmes njoftimit nga KLGJ në postën time elektronike, jam njohur me faktet e mëposhtme:

Së pari, relacionin e relatorit të çështjes që arrin në përfundimin se kërkesa ime duhet refuzuar si e pabazuar në ligj dhe në prova;

Së dyti, faktin që seanca e KLGJ për shqyrtimin e kërkesës sime do të zhvillohet me datë 21.09.2023.

Në këto kushte parashtrimi në vijim është mjeti procedural për të ushtruar të drejtën për t'u dëgjuar para marrjes së vendimit përfundimtar nga KLGJ, si dhe një mundësi për të trajtuar në mënyrë më të plotë të gjitha faktet, rrethanat dhe çështjet ligjore rreth kërkesës, çka do të pasuronte elementin e kontradiktoritetit gjatë kësaj

38

procedure administrative, me pasojë të drejtpërdrejtë në marrjen e një vendimi ligjërish të bazuar, duke qenë se këto shpjegime do të duhet të vlerësohen në përputhje me parashikimet e nenit 48 të Kodit të Procedurave Administrative.

Sikurse parashtrohej edhe në kërkesën time të datës 14.04.2023, ligji nr. 8577/2000, i cili pësoi disa ndryshime me ligjin nr.45/2021, ndër të tjera edhe nëpërmjet shtesës në nenin 18/3 të tij, që rregullon çështjen e statusit të gjyqtarit kushtetues pas mbarimit të funksionit. Mbi këtë shtesë të ligjit u bazua edhe kërkesa ime.

Duke mbajtur në konsideratë jo vetëm se bëhet fjalë për një dispozitë të ndryshuar së fundmi dhe me referenca edhe në ligje të tjera, por edhe sepse është rasti i parë që kërkohet aplikimi i saj nga gjyqtari kushtetues pas mbarimit të funksionit, vlerësoj se vetëm një interpretim i gjithanshëm, harmonik, jo vetëm i nenit 18/3 i ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe nenit 62 të ligjit për statusin, por edhe i një sërë dispozitave në ligje të tjera të lidhura me to, mund të sjellë përfundimin e bazuar në ligj të kësaj procedure administrative. Për këtë arsye gjatë këtij procesi marrin rëndësi të njëjtë të gjitha mënyrat e njohura të interpretimit të normave juridike, sikurse ai gramatikor, sistematik, qëllimor apo logjik i tyre.

Në lidhje me sa më sipër, veçanërisht i rëndësishëm paraqitet interpretimi sistematik i termave dhe instituteve përkatës jo vetëm në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe ligjin e Gjykatës Kushtetuese por edhe në ligjet e tjera të lidhura me to, duke qenë se ligjet kryesore të reformës në drejtësi u miratuan nga ligjvënësi në të njëjtën kohë sepse u konsideruan si vetë themelet e saj.

Nga ana tjetër, interpretimi i lartpërmendur duhet të jetë në përputhje me parimet e përcaktuara në Kushtetutë, në ligjet e zbatueshme në rastin konkret dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Ndër ato parime, duke i konsideruar si të lidhura drejtpërdrejt me këtë procedurë konkrete administrative, dëshiroj të theksoj sidomos:

- Parimin e shtetit të së drejtës, veçanërisht të lidhura me rastin konkret siguria juridike dhe pritshmëritë e ligjshme të gjyqtarit, parashikuar në nenin 4 të Kushtetutës, dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Kushtetuese.

- Parimin e lirisë për të zgjedhur vendin e punës, i parashikuar nga neni 49/1 i Kushtetutës dhe si i lidhur me të parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimi, të

parashikuara nga nenet 18/1-2 të Kushtetutës, neni 17 i Kodit të Procedurave Administrative, si dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

- Parimin e garantimit të të drejtave dhe përfitimeve të gjyqtarëve, konkretisht në rastin konkret të lidhura me karrierën e tyre, i parashikuar në nenin 138/1 të Kushtetutës, nenin 17/3 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese, si dhe jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Kushtetuese.

Bazuar në konsideratat e mësipërme, në këtë parashtrim do të shpreh qëndrimin tim mbi disa përfundime të relacionit që më është dërguar nga KLGJ dhe në vijim argumentet përfundimtare mbi bazueshmërinë e kërkesës.

Ashtu sikurse kam cituar tekstualisht në kërkesën e datës 14.04.2023, ritheksoj se të drejtën e parashikuar nga neni 18/2-3 i ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe neni 62 i ligjit për statusin, subjekti im e kërkon bazuar në garancinë kushtetuese të paprekshmërisë së përfitimeve që lidhen me karrierën e gjyqtarëve, si një nga të drejtat që mbrohet nga fushëveprimi i nenit 138 të Kushtetutës.

Sa më sipër sepse me emërimin si anëtar i Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 125 të Kushtetutës subjekti im fitoi statusin e gjyqtarit në Shqipëri, bazuar në parashikimet kushtetuese, ligjore, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe aktet ndërkombëtare të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Diskutimit të lindur vite më parë mbi pozicionin institucional të Gjykatës Kushtetuese, jurisprudenca kushtetuese me fuqi detyruese të përgjithshme dhe përfundimtare, i dha zgjidhje me vendimin nr. 11, datë 06.04.2010, të Gjykatës Kushtetuese, në të cilin duke marrë në shqyrtim organizimin, kompetencat dhe funksionet e saj, ndër të tjera është arritur në përfundimet e mëposhtme:

- Në kuptim të Kushtetutës dhe të legjislacionit, gjykatat që janë ngarkuar për të zbatuar drejtësi në Republikën e Shqipërisë iu përkasin disa juridiksioneve gjyqësore.

- Gjykata Kushtetuese është një “gjykatë”,emërtim i dhënë expressis verbis nga vetë Kushtetuta, e krijuar “sui generis” dhe që administron drejtësinë kushtetuese.

- Si në Kushtetutë edhe në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e saj emërtohen “gjyqtarë”, ai ka të njëjtat papajtueshmëri në ushtrimin e detyrës

sikundër edhe çdo gjyqtar i juridiksioneve të tjera. Veprimtaria e saj quhet “gjykim”, procedura e gjykimit kushtetues është shumë e ngjashme dhe, sipas rastit, edhe e njëjtë me procedurën e zbatuar në gjykimin e zakonshëm dhe vullneti i Gjykatës Kushtetuese, sikundër i çdo gjykate të cilitdo juridiksion shprehet vetëm përmes vendimeve që janë përfundimtare dhe me fuqi të përgjithshme detyruese.

- Për sa i përket mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit “për një proces të rregullt ligjor”, Kushtetuta e vendos Gjykatën Kushtetuese si trupën më të lartë të kontrollit në hierarkinë e gjykatave në Republikën e Shqipërisë.

- Shfuqizimi që Gjykata Kushtetuese i bën vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, sipas neneve 42 dhe 131/f të Kushtetutës, është në ushtrim të funksioneve të saj gjyqësore në zbatim jo vetëm të rregullit të njohur se “vendimi i një gjykate mund të prishet vetëm nga një gjykatë tjetër,” por edhe të faktit se, subjektet e interesuara, duke u paraqitur para saj për të parashtruar pretendimet e tyre, e kanë njohur dhe pranuar atë si një gjykatë.

- Edhe nga referimi në aktet ndërkombëtare, Gjykata vlerëson se rekomandimi që bëhet mbi pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve “është i zbatueshëm për të gjithë personat që ushtrojnë funksione gjyqësore, ku përfshihen ata që trajtojnë çështje kushtetuese, penale, civile, tregtare dhe administrative”.

- Neni 138 i Kushtetutës, si dispozitë garantuese e pavarësisë së gjykatave, gjen zbatim edhe për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese.

Është për këtë arsye që kërkesa ime për caktimin si gjyqtar në nivel apeli duhet të trajtohet në germën dhe frymën e institutit të garantimit të të drejtave dhe përfitimeve të gjyqtarëve, sipas nenit 138 të Kushtetutës, një prej të cilave lidhet me vijueshmërinë e karrierës së tij.

Për t’u rikthyer tek arsyetimi i relacionit, në vlerësimin tim, përfundimet e tij janë rrjedhojë e disa interpretimeve të pabazuara mbi disa çështje ligjore rreth kërkesës, të cilat i kam identifikuar si në vijim:

Lidhur me analizën dhe interpretimin e termit “magjistrat” në nenin 18/2-3 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, të interpretuar si me garanci të ndryshme karriere për gjyqtarët kushtetues, në varësi të funksionit si gjyqtar ose prokuror që ata kanë kryer përpara emërimit në Gjykatën Kushtetuese.

Lidhur me interpretimin e institutit të vijimit të karrierës së gjyqtarit kushtetues, në nenin 18/2-3 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili në relacion është trajtuar në mënyrë të gabuar si e drejta e kthimit dhe jo e drejta përcaktimin në nivel apeli, sikurse qartazi e përcakton ligji në fjalë.

Lidhur me interpretimin e nenit 18/2-3 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese, për efekt të zhvillimit të karrierës pas mbarimit të funksionit të gjyqtarit kushtetues, si instituti i ngritjes në detyrë për magjistratët.

Lidhur me çështjen e parë, mbi analizën dhe interpretimin e termit të përdorur nga ligjvënësi në nenin 18/3-2 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese, në pjesën arsyetuese të relacionit arrihet në përfundimin se sa i takon përdorimit të termit "magjistrat" ky ligj sikurse dhe ai për statusin kanë nevojë për interpretim, duke bërë të domosdoshme analizimin e mëtejshëm mbi bazën e ndarjes së funksionit të gjyqtarit nga ai i prokurorit.

Konkretisht në relacion veç të tjerash theksohet:

"Në këtë dispozitë përcaktohet qartë se magjistrati, gjyqtar apo prokuror, ka të drejtë të caktohet në një pozicion në nivel apeli. Dispozita ligjore ka përfshirë në terminologjinë e saj nocionin "magjistrati", një term i përgjithshëm që përfshin gjyqtarët dhe prokurorët.

"Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nuk ndihmon në mënyrë të posaçme individualizimin e kategorisë së magjistratit pasi objekti i tij është përcaktimi i statusit të magjistratëve (neni 1), term që sipas nenit...", -dhe këtu ka bërë referim të përmbajtjes së relacionit.

Në të kundërt me përfundimet e mësipërme të relacionit dëshiroj të theksoj bindjen time se, në raport me marrëdhënien që rregullojnë, neni 18/3-2 i ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe nenet 2/gj dhe 62/1 të ligjit për statusin, nuk paraqesin asnjë paqartësi interpretative, në përputhje me parimin kushtetues të shtetit të së drejtës që qartësinë e ligjit e prezumon si pjesë të sigurisë juridike.

Lidhur me këtë parim jurisprudenca kushtetuese ka theksuar ndër të tjera se "Parimi i sigurisë juridike kërkon domosdoshmërisht një formulim të qartë të normave ligjore, pasi një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit për t'i dhënë asaj kuptime të ndryshme dhe me pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma juridike. Është

kërkesë e parimit të sigurisë juridike fakti se një ligj në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Prandaj është detyrë e gjykatave ose organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuara të një ligji t'i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë. Por që të realizohet një gjë e tillë, para së gjithash ligji duhet kuptuar saktë dhe drejtë. Prandaj duhet bërë i qartë qëllimi i hartimit të tij. Ai duhet të përcaktojë mjetet e ndërhyrjes, subjektet të cilave u drejtohet, raportet e caktuara të sjelljes dhe mënyrën e zbatimit të tij. Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm dhe pasojat të parashikueshme për subjektet të cilave u drejtohet ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij.

Duke mbajtur në konsideratë sa më sipër, në vlerësimin tim, për interpretimin e termit “magjistrat” në nenin 18/3-2 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese relacioni nisët nga një premisë e pambështetur në tekstin e normës dhe si e tillë e gabuar, sepse përfitimet e karrierës pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues që vjen nga magjistratët i trajton në mënyrë të ndryshme, në varësi të funksionit gjyqtar apo prokuror para emërimit. Sa më sipër nuk rezulton që të jetë as formulimi i ligjit dhe as qëllimi i ligjvënësit, përfundim në të cilin arrihet nga analiza gjithëpërfshirëse e mënyrave të interpretimit të normave juridike.

Kështu nisur nga interpretimi gjuhësor dhe sistematik i nenit 18/3-2 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese, termi i përdorur tekstualisht nga ligjvënësi për zhvillimin e karrierës pas funksionit të gjyqtarit kushtetues është “magjistrat”, sipas përcaktimit të nenit 2/gj të ligjit për statusin.

Ligjvënësi duke përdorur një term të tillë, me vullnetin dhe kompetencën e tij të plotë, nuk ka parashikuar asnjë diferencim për efekt të vijimit të karrierës pas funksionit të gjyqtarit kushtetues, si në rastin kur magjistratët vijnë nga gjyqtarët, prokurorët apo kryetarët e zyrave përkatëse.

Në lidhje me interpretimin gjuhësor Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ndër të tjera ka theksuar se “...në kuadër të parimeve të shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike, në tekstin e ligjit çdo fjalë mbart një kuptim të caktuar që i shërben qëllimit të vetë ligjit, nga njëra anë, dhe aspektit të parashikueshmërisë së normave juridike, nga ana tjetër. Me fjalë të tjera, argumenti se një dispozitë ligjore duhet të lexohet dhe të

zbatohet duke anashkaluar fjalë të caktuara për shkak se ato janë të tepërta ose të parëndësishme, nuk mund të pranohet, sepse bie ndesh me parimet kushtetuese.

Në kuptim të sa më sipër, nëse vullneti i ligjvënësit për zhvillimin e karrierës pas mbarimit të mandatit do të ishte për një trajtim të ndryshëm të gjyqtarëve kushtetues që vijnë nga magistratët në varësi të funksioneve që kanë kryer para emërimit, sikurse sugjeron relacioni në pjesën e lartpërmendur, nuk do të kishte asnjë vështirësi nga pikëpamja e teknikës legjislativë që dispozita të formulohej pikërisht në varësi të funksionit të mëparshëm, sikurse rezulton në ligje të tjera që rregullojnë statusin e magistratëve pas mbarimit të funksioneve të caktuara.

Për të përmendur disa raste nga ligje të tjerë të reformës në drejtësi, në funksion të interpretimit edhe sistematik të nenit 18/3-2 të Gjykatës Kushtetuese, po citoj disa nga nenet e ligjit nr. 115/2016, “Për qeverisjen e organeve të sistemit të drejtësisë” që posaçërisht rregullojnë çështjen e vazhimit të karrierës së magistratëve, - dhe ka përmendur nenin 4 ligjit nr. 115, nenin 102/4, neni 203/3, neni 250/5, neni 265/4.

Dispozitat krahasimore të përmendura më sipër tregojnë qartazi se në rastet kur qëllimi i ligjvënësit, në çështje që lidhen me statusin apo zhvillimin e karrierës së magistratëve ka qenë të individualizojë në termin “magjistrat” funksionet e veçanta si gjyqtar ose si prokuror, e ka përcaktuar diçka të tillë në mënyrë literale. Por ky nuk është rasti i nenit 18/3-2 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese në të cilin, me vullnetin e plotë të ligjvënësit, e drejta e karrierës pas mbarimit të funksionit garantohet njëjloj për të gjithë magistratët, sipas përcaktimit gjithëpërfshirës të këtij termi në nenin 2/gj të ligjit për statusin. Veçanërisht formulimi i qartë dhe pa asnjë ekuivok i nenit 203/3 të ligjit nr. 115/2016, është argumenti më bindës në mbështetje të konkluzionit të mësipërm, nga njëra anë dhe pathemeltësisë së përfundimeve të relacionit, nga ana tjetër.

Një interpretim i kundërt në rastin konkret, që do të anashkalonte përcaktimin e termi të ligjit sipas vullnetit të ligjvënësit, do të ishte në kundërshtim me një sërë parimesh themelore kushtetuese, sikurse ai shtetit të së drejtës i përcaktuar në nenin 4 të Kushtetutës dhe jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Kushtetuese sipas së cilës “atë që nuk e ka parashikuar ligji nuk mund ta përcaktojë organi publik”, apo parimin e ndarjes së pushteteve sipas nenit 7 të Kushtetutës, sepse në një rast të tillë organi administrativ do

të merrte kompetenca të pushtetit legjislativ duke e interpretuar ligjin në mënyrë të ndryshme nga formulimi i ligjvënësit.

Lidhur me çështjen e dytë, që në vlerësimin tim ka të bëjë me një tjetër përfundim të gabuar të relacionit, atë të përcaktimit të institutit që duhet të zbatohet mbi kërkesën time si kthimi në detyrën e mëparshme, në pjesën arsyetuese të tij bëhet një analizë e dallimeve midis funksioneve të gjyqtarit dhe prokurorit, nisur nga fakti se subjekti im para emërimit si gjyqtar kushtetues kryente detyrën e prokurorit të apelit.

Një analizë e tillë nuk ka ndikim mbi përfundimet e kësaj procedure administrative, sikurse e përmenda edhe më sipër, subjekti im të drejtën dhe përfitimin e parashikuar në nenet 18/3-2 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe nenit 62 të ligjit për statusin i pretendon nga statusi i gjyqtarit, dhe jo ai i prokurorit, bazuar në nenet 125 dhe 138 të Kushtetutës dhe nenet 17/3 dhe 18/3 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese.

Sikurse kam parashtruar edhe në kërkesë, pas një eksperience shumëvjeçare si magjistrat, për subjektin tim më datë 17.12.2020 statusi i prokurorit ndryshoi në atë të gjyqtarit, ndryshim që është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 125 të Kushtetutës, nenit 7/c të ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe po ashtu të neneve 1/3, 3/1 dhe 4/1 të Kartës Evropiane për Statusin e Gjyqtarit dhe neneve 1/3, 2.1, 2.2 dhe 4.1 të Memorandumit shpjegues të saj. Emërimi im si gjyqtar erdhi në përfundim të një procedure të parashikuar rigorozisht në Kushtetutë dhe në ligj, të zhvilluar me radhë nga KED, Kuvendi i Shqipërisë dhe Presidenti i Republikës.

Por pavarësisht nga sa më sipër, në paragrafët përkatës të relacionit analizohet funksioni i prokurorit, respektivisht natyra dhe kompetencat e tij, emërimi, sistemi i karrierës si dhe organet e emërtesës, të cilat në rastin konkret nuk kanë asnjë lidhje me funksionin e kryer nga subjekti im në Gjykatën Kushtetuese.

Kurse lidhur me funksionin e gjyqtarit në relacion ndër të tjera theksohet se: [...], - dhe përmend ose citon pjesë të përmbajtjes së relacionit.

Pikërisht si ky citim nga relacioni ka qenë funksioni i subjektit tim në Gjykatën Kushtetuese, sikurse në përbërje të një organi kolegjal të zgjidhja çështjet në kompetencë të juridiksionit kushtetues, nëpërmjet dhënies së vendimeve pas procedurave gjyqësore, sipas neneve 124 dhe 131 të Kushtetutës dhe neneve 20 e vijues të ligjit të Gjykatës Kushtetuese.

Në fund të analizës së kësaj pjese, mbi funksionet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, në relacion arrihet në përfundimin e paparashikuar në ligj se:

“Ligjvënësi, fuqizoi garancitë statuale në rastin konkret të, ligjit nr.8577, datë 10.2.2000, duke garantuar kthimin e prokurorit apo gjyqtarit pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues në gjyqtar apo prokuror në nivel apeli.

Në këtë kuadër, pas mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, ligji i garanton kërkuesit kthimin e tij si prokuror në nivel apeli.

Dëshiroj të theksoj se një përfundim i tillë i relacionit është haptazi në kundërshtim me ligjin material, pasi instituti që garantohet nga neni 18/3-2 i ligjit për Gjykatën Kushtetuese është literalisht ai i të drejtës për t’u caktuar në një pozicion në nivel apeli, njëllor sikurse parashikohet në nenin 62 të ligjit për statusin, institut i cili është krejtësisht i ndryshëm nga ai që garanton të drejtën e kthimit në funksionin e mëparshëm, sipas nenit 60 të ligjit për statusin.

Nëse përfundimi i mësipërm i relacionit do të pranohej nga KLGJ, në rastin e kësaj procedure administrative do të viheshin në dyshim jo vetëm parimet themelore kushtetutës të përmendura më sipër, por specifikisht edhe parimi i ligjshmërisë, në përputhje me nenet 4 dhe 109/d të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit përmbajtja e aktit administrativ duhet të përputhet me përmbajtjen e ligjit.

Në të drejtën administrative është përcaktuar qartë se një akt administrativ është i paligjshëm si në rastin kur i mohon subjektit të drejtën e njohur nga ligji, po ashtu edhe në rastin kur i njeh subjektit një të drejtë që nuk ia njeh ligji.

Përfundimi i lartpërmendur i relacionit rezulton të jetë po ashtu në kundërshtim flagrant me jurisprudencën e detyrueshme të Gjykatës Kushtetuese, e cila posaçërisht në çështje që lidhen me statusin e gjyqtarëve ka theksuar se “... Gjykata vlerëson të theksojë se është akti nënligjor që duhet të ndjekë konceptet dhe terminologjinë e ligjit dhe jo anasjelltas.

Lidhur me këtë çështje dëshiroj të theksoj se ligji për statusin, nëpërmjet parashikimeve të posaçme në kapitujt e tij, bën një identifikim dhe dallim të qartë të instituteve që përcaktojnë karrierën e magjistratit, ndër të cilat për rastin konkret është me vend të analizohet formulimi i neneve 60 dhe 62 të ligjit për statusin, në raport me nenin 18/3 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese. - Citon nenin 60/1, 62/1 të ligjit për statusin.

Ndërkohë që neni 18/3 i ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ka formulimin e mëposhtëm:

”Në përfundim të mandatit, me përjashtim të rastit kur shkarkohet nga detyra sipas procedurave të përcaktuara në ligj, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese caktohet në një detyrë tjetër të barabartë ose të përafërt, si dhe përfiton pagesë sipas legjislacionit në fuqi.

Në rastet kur përpara emërimit gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzonte statusin e magjistratit, në përfundim të mandatit si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka të drejtë të caktohet të paktën në një pozicion në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose në prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion”.

Nga formulimi i dispozitave të mësipërme, në funksion të analizës së kërkesës në shqyrtim, veç të tjerave mund të nxirren lehtësisht përfundimet e mëposhtme:

Së pari, që në ligjin për statusin instituti i kthimit në detyrën e mëparshme është krejtësisht i ndryshëm nga instituti i të drejtës për caktimin në nivel apeli.

Së dyti, që formulimet në nenin 62 të ligjit për statusin dhe nenin 18/3-2 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese janë të njëjta dhe ato i referohen të njëjtit instituti material, atij të së drejtës për caktimin në nivel apeli të gjyqtarit kushtetues që vjen nga magjistratët dhe jo atij të kthimit në funksionin e mëparshëm sipas nenit 60 të ligjit për statusin (madje për gjyqtarët kushtetues garancia rezulton e përforcuar nga përdorimi i fjalës “të paktën” në nenin 18/2-3 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në jurisprudencën kushtetuese të sipërcituar se në tekstin e ligjit çdo fjalë ka një kuptim të caktuar).

Sa më sipër sepse me ndryshimet në ligjin 45/2021 gjyqtarët kushtetues u përfshinë në kategorinë e subjekteve të parashikuara nga neni 62/1 të ligjit për statusin, në përputhje me hapësirën ligjore që ligjvënësi i ka lenë vetes për të përfshirë në atë dispozitë edhe subjekte nga ligje të tjera.

Referuar formulimit të nenit 60 të ligjit për statusin rezulton se instituti i kthimit në detyrën e mëparshme përcaktohet si e drejta e magjistratit, që nuk është përkohësisht në gjendje të ushtrojë funksionin për shkaqet e parashikuara shprehimisht në ligj, që të kthehet në pozicionin e mëparshëm pas përfundimit të shkakut ligjor përkatës.

Duke iu rikthyer dallimeve mes dy instituteve, atyre të parashikuara në nenet 60 dhe 62 të ligjit për statusin, bazuar në interpretimin gjuhësor të termave sipas fjalorit të gjuhës shqipe, me të drejtën do të kuptohet mundësia që sigurohet me ligj për të

gëzuar, përdorur apo kërkuar diçka, kurse me kthimin kuptohet t'i japësh dikujt atë që i ke marrë ose që ai e ka dhënë.

E interpretuar në rastin e magjistratëve sipas nenit 60 të ligjit për statusin, nga e drejta e kthimit magjistrati përfiton garancinë e vetme që të rikthehet në funksionin konkret të mëparshëm, si gjyqtar apo prokuror, të cilin përkohësisht nuk ka patur mundësi ta ushtrojë për shkak të verifikimit të një prej kushteve të parashikuara në nenin 59/1 ose 59/2 të ligjit.

Kurse e drejta e magjistratit për caktimin në nivel apeli, sipas nenit 62 të ligjit për statusin dhe nenit 18/3-2 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese, është një institut krejt i ndryshëm nga ai i parashikuar në nenin 60 të tij.

Nga pikëpamja e interpretimit gjuhësor të nenit 62 të ligjit për statusin, sipas fjalorit të gjuhës shqipe me caktim do të kuptohet vendosja në një detyrë, duke mos qenë i lidhur domosdoshmërisht ky koncept vetëm me kthimin në detyrën e mëparshme sikurse në rastin e nenit 60 të ligjit për statusin. (ndërpritet audio).

Naureda Llagami: Tani u rilidh prapë linja.

Të lutem Alban, mund ta vazhdosh.

Alban Toro: Po!

Nga pikëpamja e interpretimit gjuhësor të nenit 62 të ligjit për statusin, sipas fjalorit të gjuhës shqipe me caktim do të kuptohet vendosja në një detyrë, duke mos qenë i lidhur domosdoshmërisht ky koncept vetëm me kthimin në detyrën e mëparshme sikurse në rastin e nenit 60 të ligjit për statusin.

Ndërkohë që, lidhur sërish me interpretimin gjuhësor të nenit 62 të ligjit për statusin dhe identikisht nenit 18/2-3 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese, në fjalorin e gjuhës shqipe përkatësia përkufizohet si një gjendje ku secili është i lidhur me diçka që i takon.

Pra, sikurse rezulton nga formulimi dhe interpretimi i tij, neni 62 i ligjit për statusin përfaqëson si një përfitim ashtu edhe një garanci karriere, që sipas përcaktimeve kushtetuese dhe ligjore nuk mund të preken apo kufizohen, përfitim që e gëzojnë vetëm një kategori e kufizuar magjistratësh, rigorozisht e përcaktuar në ligj, për shkak të caktimit me mandat të kufizuar në shkallët më të larta të juridiksioneve përkatës.

Ky institucion parashikon që pas mbarimit të mandatit të kufizuar, subjektet e përfshirë në nenin 62 të ligjit për statusin të kenë njëkohësisht 2 garanci dhe përfitime, së pari të caktohen në nivelin e apelit dhe së dyti, koncepti i përkatësisë u jep atyre të drejtën ta zgjedhin vetë ku do ta ushtrojnë funksionin, në gjykatat apo në prokuroritë e nivelit të apelit. Ky përfitim i fundit për këta subjekte është në harmoni edhe me të drejtën themelore ekonomike kushtetuese për zgjedhjen e vendit të punës, e parashikuar në nenin 49/1, fjalia e dytë, të Kushtetutës, sepse nuk ka asnjë arsye që lidhet me dobishmërinë, domosdoshmërinë apo proporcionalitetin, sipas nenit 17 të Kushtetutës dhe jurisprudencës kushtetuese përkatëse, që të kufizohet një e drejtë e tillë për gjyqtarin kushtetues në rastin konkret.

Në kuptim të sa më sipër, referuar kuadrit ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë, kategoritë e subjekteve me mandat të kufizuar që aktualisht përfitojnë të drejtën e parashikuar nga neni 62 i ligjit për statusin rezultojnë të jenë si më poshtë:

- Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, sipas përcaktimit në nenin 62/1 të ligjit për statusin.

- Prokurori i Përgjithshëm, sipas përcaktimit në nenin 148/a-5 të Kushtetutës dhe nenin 62/1 të ligjit për statusin.

- Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, kur përpara emërimit gëzonin statusin e magjistratit, sipas përcaktimit të nenit 18/3-2 të ligjit organik për Gjykatën Kushtetuese, të ndryshuar me ligjin nr. 45/2021, të lidhura me nenin 62/1 të ligjit për statusin.

Nisur nga kategoria e subjekteve përfitues sipas nenit 62 të ligjit për statusin, mund të nxirret edhe një konkluzion për qëllimin e ligjvënësit mbi nevojën e parashikimit edhe të një instituti të tillë të lidhur me karrierën e magjistratëve, krahas atij të kthimit në detyrën e mëparshme apo instituteve të tjerë.

Kategoria e lartpërmendur përfshin subjektet që e ushtrojnë funksionin, me mandat të kufizuar, në shkallën më të lartë të juridiksionit kushtetues, juridiksionit gjyqësor dhe të ndjekjes penale në emër të shtetit.

Jo vetëm nga kompetenca për zgjidhjen në shkallë të fundit të çështjeve në kompetencë, por edhe sepse kushtet dhe kriteret kushtetuese dhe ligjore për emërimin e tyre janë në nivelin më të lartë të kërkuar, në përputhje edhe me parashikimet e dokumenteve ndërkombëtare të kësaj fushe të njohura nga Republika e Shqipërisë,

ligjvënësi u ka njohur të drejtën magjistratëve me një profil të tillë që pas kontributit në mandate të kufizuar të shkallëve më të larta ta vijojnë karrierën në nivel apeli, sipas zgjedhjes së tyre në gjykata ose në prokurori, duke e konsideruar pikërisht eksperiencën e tyre në shkallët më të larta të juridiksioneve respektive si një vlerë të shtuar për sistemin e drejtësisë.

Specifikisht për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, ligjvënësi veç të tjerash mban qëndrimin se “Gjykata Kushtetuese ka juridiksion përfundimtar kontrolli për kushtetutshmërinë e vendimeve që japin të gjitha gjykatat e zakonshme dhe të posaçme, përfshi gjykatat e posaçme për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Kushtetuta e ka veshur Gjykatën Kushtetuese me përgjegjësi ekskluzive për sa i takon kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve normative, zgjidhjes së konflikteve të kompetencave midis organeve të tjera kushtetuese dhe kontrollit të papajtueshmërive dhe kushteve të zgjedhshmërisë të funksionarëve të organeve kushtetuese. Vendimet e Gjykatës mbi këto çështje kanë fuqi të përgjithshme rregulluese dhe qëndrojnë në një nivel më të lartë se ligjet në sistemin e hierarkisë së normave. Këto përgjegjësi të larta nënkuptojnë se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese përfaqësojnë nivelin më të lartë të ekspertizës, përgjegjësisë dhe rëndësisë protokollare në sistemin shtetëror. Vendimet e Gjykatës afektojnë jetën politike, shoqërore dhe ekonomike të vendit njëjloj si ligjet dhe në rast përplasjeje me to (ligjet) mbizotërojnë”.

Pikërisht sepse konsiderohet si një përfitim vetëm për funksionet e lartpërmendura, veç të tjerash dhe në çështje që lidhen me zhvillimin e karrierës së magjistratëve, ligjvënësi ka parashikuar që në rastin e funksioneve të lira magjistratët që përfitojnë nga e drejta për caktim në nivel apeli të jenë të parët që përzgjidhen dhe pastaj sipas radhës përzgjidhen magjistratët e tjerë, sikurse përcaktohet qartazi radha prioritare në nenet 42/3 dhe 42/4 të ligjit për statusin.

Ndërkohë që sikundër parashtrova edhe më sipër, kur ligjvënësi ka patur si qëllim që për efekt të zhvillimit të karrierës të përcaktojë si të aplikueshëm vetëm institutin e kthimit në vendin e mëparshëm, e ka dalluar qartë atë nga instituti i të drejtës për t’u caktuar në nivel apeli, apo edhe nga institute të tjera që përcaktojnë pozicionin e karrierës së magjistratit.

Në ligjin për statusin, si dispozita që identifikojnë qartë dallime të tilla, mund të përmenden si më poshtë: Neni 13/3, Neni 57/4.

Në mbështetje të konkluzionit të mësipërm dhe bazuar në parimet e interpretimit gjuhësor, qëllimor, logjik dhe sistematik të normave juridike, dispozita të tjera që e bëjnë më se të qartë dallimin midis institutit të së drejtës për caktim në nivel apeli, nga ai i kthimit në detyrën apo funksionin e mëparshëm, janë nenet 148/a-5 i Kushtetutës i lidhur me nenin 62 të ligjit të statusit, apo nenet 4/4, 102/4, 203/3, 250/5 dhe 265/4 të ligjit nr. 11 /2016.

Nga interpretimi harmonik i këtyre dispozitave rezulton se në rastin e institutit të kthimit, sipas nenit 60 të ligjit për statusin, magjistrati gëzon të drejtën të kthehet në funksionin e mëparshëm që ka patur përpara emërimin në mandatin e kufizuar. Për disa nga funksionet e mësipërme garantohet kthimi rigorozisht vetëm në detyrën dhe shkallën e mëparshme, ndërkohë që për disa të tjera kthimi në funksionin si gjyqtar ose prokuror garantohet edhe për nivelin e apelit, sikurse në rastin e ILD-së.

Ndërkohë që vetëm për subjektet që përfitojnë nga garancitë e nenit 62 të ligjit për statusin është parashikuar edhe e drejta tjetër, që të jenë ata vetë që të zgjedhin nëse karrierën do ta vijojnë si gjyqtar ose prokuror në nivelin e apelit, në respektim të së drejtës themelore kushtetuese të zgjedhjes së vendit të punës sipas nenit 49/1 të Kushtetutës.

Për tërësinë e argumenteve të lartpërmendur dhe lidhur me këtë çështje, në vlerësimin tim është haptazi i pambështetur në ligj përfundimi i relacionit se gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese pas mbarimit të funksionit përfiton nga e drejta e kthimit sipas nenit 60 të ligjit për statusin, sepse sipas parashikimeve ligjore, këtij subjekti i garantohet e drejta për caktimin në nivel apeli, sipas nenit 18/2-3 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe nenit 62 të ligjit për statusin.

Kurse lidhur me argumentin e fundit të relacionit, sipas të cilit në rastin konkret kërkesa nuk duhet pranuar pasi nuk përmbushen kriteret e ngritjes në detyrë, në relacion veç të tjerash theksohet si më poshtë: [...], - duke dhënë përmbajtje të relacionit dhe duke cituar përmbajtjen e dispozitës së nenit 47 të Ligjit nr. 96/2016, për ngritjen në detyrë.

Në vlerësimin tim edhe ky përfundim i relacionit është i gabuar dhe shkak duhet kërkuar te premisa e paparashikuar në ligj, sipas së cilës pas përfundimit të funksionit

të gjyqtarit kushtetues me status të mëparshëm të magjistratit, caktimi i tij në pozicionin e nivelit të apelit rregullohet nga instituti i ngritjes në detyrë.

Një përfundim i tillë është i pabazuar sepse në ligjin për statusin rastet e ngritjes në detyrë të magjistratëve janë përcaktuar në një listë rigorozisht shteruese, pikërisht në 4 rastet e nenit 47/1 të tij, që gjenden të cituara literalisht edhe në relacion. Qartazi rasti i subjektit tim nuk ka të bëjë me asnjë prej tyre, jo vetëm kaq por aplikimi sipas kërkesës sime është e kundërta e ngritjes në detyrë.

Në thelb kjo procedurë, e lidhur me karrierën e magjistratit, nuk është ngritje por ulje në detyrë për shkaqe të parashikuara në ligj. Kalimi nga niveli i gjyqtarit kushtetues në atë të gjyqtarit të apelit padyshim mund të konsiderohet ulje në karrierë, duke mbajtur parasysh elementët që përcaktojnë statusin dhe pozicionin e gjyqtarit kushtetues sikurse janë:

- kriteret më të larta profesionale të kërkuara për emërimin e gjyqtarit kushtetues që vjen nga magjistratët, sipas parashikimeve të nenit 125 të Kushtetutës;

- kompetencën funksionale të gjyqtarit kushtetues, ku krahas të tjerave është edhe ajo subsidiare për shqyrtimin në instancë të fundit të ankimeve kushtetues individuale kundër vendimeve gjyqësore;

- paga që përfitojnë gjyqtarët kushtetues;

- përfitimet e tjera të gjyqtarëve kushtetues;

- përfitimet suplementare;

- statusi protokollar i gjyqtarit kushtetues, sipas nenit 19/2 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Duke mbajtur në konsideratë sa më sipër statusi dhe pozicioni i karrierës i gjyqtarit kushtetues rezulton të paktën një shkallë më lart, në raport me atë të gjyqtarit të nivelit të apelit.

Jo vetëm për këtë arsye por para së gjithash sepse nuk rezulton e parashikuar në nenin 47/1 të ligjit për statusin, është i pabazuar në ligj interpretimi se kalimi nga pozicioni i gjyqtarit kushtetues në atë të gjyqtarit të apelit i nënshtrohet institutit të ngritjes në detyrë.

Përkundrazi një lëvizje e tillë konsiderohet ulje në detyrë, por jo e paligjshme sepse është pikërisht ligji që në raste të caktuara e lejon diçka të tillë.

Në nenin 22 të ligjit për statusin përcaktohet ndër të tjera se:

“Paga dhe përfitimet e tjera të magjistratit nuk mund të ulen, me përjashtim të rasteve kur, b) magjistrati ushtron të drejtën për t’u kthyer nga një pozicion i mëparshëm më i lartë ose më i specializuar ose me mandat të kufizuar dhe me pagesë më të lartë”.

Nga ana tjetër dhe krejtësisht në të kundërt të përfundimeve të relacionit, tanimë nga pikëpamja e interpretimit sistematik të normës dhe krahas nenit 13/3 të cituar më sipër, është vetë ligji për statusin që edhe në dispozita të tjera të tij e dallon qartë institutin e të drejtës për caktimin në nivel apeli nga instituti i ngritjes në detyrë.

Jep përmbajtjen e nenit 42 (të plotë).

Sikurse rezulton nga formulimet e mësipërme, është vetë ligji për statusin që në fazat e ndryshme të zhvillimit të karrierës së magjistratëve e ka përcaktuar literalisht dallimin e aplikimit të institutit të ngritjes në detyrë, sipas nenit 47 të ligjit për statusin, nga ai i të drejtës për caktimin në nivel apeli, sipas nenit 62 të tij.

Për tërësinë e argumenteve të përmendura më sipër rezulton e qartë se, bazuar në ligjin material nr. 96/2016 për statusin, instituti i ngritjes në detyrë është krejtësisht i ndryshëm nga ai i së drejtës për caktimin në nivel apeli, arsye për të cilën nuk mund të përdoren kriteret e parashikuara në 47 të ligjit për statusin si shkak për mospranimin e kërkesës sipas të drejtave që burojnë nga neni 62 i tij.

Kriteret për ngritjen në detyrë sipas nenit 47/1 të statusit kërkohen për karrierën nga shkallët e ulëta për në ato më të larta të magjistratëve. Ndërkohë që kriteret për funksionet me mandate të kufizuar të përcaktuar në nenin 62/1 të ligjit për statusin, janë ato që kërkohen për magjistratët që e ushtrojnë funksionin në shkallën e tretë të karrierës. Kur karriera e magjistratit arrin në shkallën më të lartë, sikurse janë funksionet e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarit të Gjykatës së Lartë apo Prokurorit të Përgjithshëm, të përmendura në nenin 62/1 të ligjit për statusin, nuk është parashikuar në ligj dhe nuk ka kuptim logjik që për caktimin në një pozicion të nivelit më të ulët, sërish të kërkohet të plotësohen kriteret që janë përmbushur më parë, në momentin e ngritjes në detyrat më të larta të parashikuara në ligj.

Duke qenë se neni 18/3-2 i ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe neni 62 i ligjit për statusin i garantojnë të njëjtin përfitim karriere subjektit të cituar literalisht “magjistrat”, duke mos diferencuar funksionet e gjyqtarit nga ato të prokurorit para emërimit,

parashikimi i nenit 47/4 të cituar në relacion, shërben si referencë për kriterin e viteve të përvojës profesionale të kërkuar për pozicionin e magjistratit të shkallës së dytë, që në rastin e subjektit tim është i plotësuar mbi trefishin e parashikuar në këtë dispozitë.

Në rast të një interpretimi të kundërt, si ai që sugjeron relacioni, procedurat për aplikimin e nenit 62 të ligjit për statusin edhe ndaj subjekteve të tjerë të përfshirë në atë dispozitë do të binin ndesh me parimet e shtetit të së drejtës, sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme. Sa më sipër, jo vetëm gjyqtarëve kushtetues me status të magjistratit, por edhe gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë që vijnë nga jogjyqtarët, konkretisht edhe atyre aktualisht në funksion, edhe Prokurorit të Përgjithshëm, konkretisht edhe atij në detyrë, do të duhej që pas përfundimit të mandatit t'u refuzohej kërkesa për caktimin në gjykatat e nivelit të apelit me argumentin se nuk e kanë ushtruar funksionin si gjyqtarë të paktën për 7 vjet përpara emërimit në funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë apo Prokurorit të Përgjithshëm, çka do të ishte në kundërshtim flagrant me parashikimet kushtetuese.

Zgjidhje të tilla do të binin në kundërshtim të plotë edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese lidhur me zbatimin e normave juridike, sipas së cilës në shqyrtimin e çështjeve konkrete prezumimi ligjor është që një normë duhet të interpretohet në kuptimin që lejon zbatimin e saj, jo në atë që e përjashton këtë zbatim, sikurse arsyetohet në vendimin nr. 7, datë 24.02.2016.

Për tërësinë e argumenteve të trajtuara më sipër në rastin e kërkesës së subjektit tim nuk ka asnjë paqartësi interpretative, me kushtin që interpretimi i normave juridike të aplikueshme në këtë rast të bëhet në pajtim me parimet kushtetuese, për të cilin Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj është shprehur veç të tjerave se "...nëse është e mundur që një ligj apo normë ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë dhe vetëm njëra prej këtyre interpretimeve është në pajtim me Kushtetutën, gjykata zgjedh këtë të fundit. Kjo metodë kërkon efektet kushtetuese të rezultateve të ndryshme dhe përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat themelore të individëve.

Kuptimi dhe interpretimi në këtë mënyrë i normave juridike të zbatueshme në çdo rast konkret është i detyrueshëm, pasi referuar sërish jurisprudencës kushtetuese janë pikërisht organet shtetërore dhe gjykatat interpretuesit e parë të Kushtetutës.

Të nderuar anëtarë të KLGJ-së.

Sikurse parashtroja në kërkesën time të datës 14.04.2023, por edhe në përmbledhje të arsytimit të këtij parashtrimi, rishpreh bindjen se subjekti im i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e kërkuara nga neni 18/3-2 i ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe neni 62/1 i ligjit për statusin, për t'u caktuar si gjyqtar në nivel apeli.

Bazuar në parashikimet e atyre dispozitave:

Rezulton i plotësuar kushti paraprak, ai që përpara emërimit si gjyqtar kushtetues subjekti im gëzon statusin e magjistratit, prej 23 vitesh, në kuptim të përcaktimeve të neneve 2/gj dhe 164/1 të ligjit për statusin dhe nenit 18/2-3 të ligjit të Gjykatës Kushtetuese.

Rezultojnë gjithashtu të plotësuara edhe kriteret e kërkuara për funksionet e magjistratëve të niveleve të ndryshme, sikurse në nenin 28/a-b-d-dh-ë-f, i cili është referencë edhe për nene të tjera të ligjit për statusin ku parashikohen kriteret për t'u plotësuar, sikurse në nenet 36/3 dhe 49/2 të tij.

Rezulton po ashtu i tejkaluar mbi trefishin edhe kriteri i viteve të përvojës profesionale, që duhet të kenë magjistratët për t'u caktuar në pozicione të nivelit të apelit.

Së fundi subjekti im nuk ndodhet aktualisht në asnjë prej rasteve të parashikuara në nenin 66/1,2 të ligjit për statusin, që parashikon mospërbushjen e kriterëve të nenit 28 të ligjit, apo mospërbushjen e kushteve sipas nenit 6.

Pra në përfundim të relacionit, aplikanti kërkon që të pranohet kërkesa e tij me arsytimet të cilat unë citova.

Kështu që ju falënderoj për vëmendjen e veçantë, në emër edhe të aplikantit.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit z. Toro për relacionin e detajuar dhe relatimin e çështjes në mënyrë të plotë.

Nëse kemi diskutim nga kolegët?

Yllka Rupa: Relacioni mbi projektligjin për ndryshimin e nenit 18 të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" ka diçka specifike lidhur me institutin e caktimit në një pozicion apeli, sepse nuk ndodh në mënyrë të shprehur në

55

relatimin që ju bëtë. Dhe doja të dija në lidhje me këtë përcaktim/ndryshim, ka një opinion të monitoruesve ndërkombëtarë në momentin që është trajtuar si projektligj?

Alban Toro: Unë mendoj që ky relacion i dërguar nga Parlamenti si kërkesë që ka bërë një nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, është në dispozicionin tuaj. Gjithsesi unë e relatova, dhe aty del qartë që në kontekstin e kohës, pra të kohës kur gjithë sistemi gjyqësor ishte me një hemorragji të theksuar për shkak të vetingut dhe askush nuk dëshironte të kandidonte pranë kësaj gjykate, pranë Gjykatës Kushtetuese, duke vendosur në risk ekzistencën e kësaj gjykate, atëherë ligjvënësi, për të shëruar këtë pjesë të mungesës së interesit nga kandidatët magjistratë, ku përfshihen prokurorët dhe gjyqtarët, modifikoi dispozitën përkatëse dhe u dha të drejtën duke u shprehur nominalisht/shprehimisht “in expressis verbis”: Gjyqtarëve dhe prokurorëve që pas mbarimit të mandatit, këta të inkludoheshin në pozicionet në nivel apel si gjyqtar dhe si prokuror. Dhe në këtë kontekst unë nuk besoj që do të kishte nevojë - siç e kam thënë edhe në seancën e fundit - edhe për kërkesën për të administruar relacionin e Parlamentit sepse ligji ishte jashtëzakonisht i qartë në këtë kontekst. Të gjithë këto institucione janë vendosur në kapitullin e mandateve të kufizuara dhe duke pasur për bazë statusin e gjyqtarit, të drejtat që garanton ai, qëndrueshmërinë deri në fund të detyrës së gjyqtarit apo prokurorit në figurën e magjistratit, ligji ka parashikuar instrumentin që në momentin kur mbaron funksionin si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, magjistrati në veshjen e gjyqtarit apo të prokurorit, të rikthehej përsëri tashmë në pozicion apeli, si gjyqtar apo si prokuror. Kjo ka rezultuar nga relacioni të cilin unë lexova (relacioni i Parlamentit). Kjo del edhe nga diskutimet që vetë parlamentarët, të cilët i prezumojmë me dituri të theksuar, kanë evidentuar faktin që personi (gjyqtar apo prokuror) nëse do të kandidonte dhe do të caktohej, kishte të drejtën të kthehej përsëri si gjyqtar apo prokuror në nivel apel. Pra ky ishte thelbi dhe i atyre që kanë projektuar ndryshimet ligjore.

Yllka Rupa: Pra ju po thoni që në mënyrë empirike qëllimi i ndryshimit në nenin 18 është garantimi i karrierës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët që kanë statusin e magjistratit.

Alban Toro: Patjetër!

Yllka Rupa: Faleminderit!

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim tjetër nga kolegët?

Ndonjë mendim?

Atëherë, nëse nuk kemi, kalojmë në votim me propozimin që ka sjellë komisioni. Pra procedura është, nëse keni propozime të tjera të ndryshme nga Komisioni, hidhen ato të parat në votim. Ndryshe, nëse s’kemi diskutime, kalojmë tek propozimi që ka Komisioni.

Atëherë, hedhim në votim propozimin që ka Komisioni, që ka të bëjë me refuzimin e kërkesës së z. {...}.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Unë ndaj një opinion tjetër, domethënë jam kundër propozimit që vjen nga relatori dhe ndaj opinionin që gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese... Jam pro kërkesës së paraqitur nga z. {...}. Opinioni im është që gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese duhet të ketë një vazhdimësi karriere, pavarësisht statusit të magjistratit në një pozicion apeli, duke qenë se edhe qëllimi i ndryshimit në ligjin “Për organizimin e Gjykatës Kushtetuese” është pikërisht caktimi në një pozicion apeli. Kështu që unë s’isha përgatitur për një votim sot, por që këtë opinion do ta argumentoj me shkrim. Faleminderit!

Klodian Kurushi: Dakord me relacionin dhe propozimin e z. Toro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Të refuzojë kërkesën z. {...} për caktimin në pozicionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Kërkuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar. [...].

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.05.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):³

4.1 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

4.2 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

4.3 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

4.4 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

4.5 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;

4.6 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

4.7 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

4.8 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;

4.9 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

³ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 5 sipas rendit të ditës.

4.10 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative;

4.11 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 14:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 7. Ridvan Hado*** (anëtar)
- 8. Alban Toro*** (anëtar)
- 9. Markelian Koça*** (anëtar)
- 10. Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Emona Muçi.***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.***
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***
- 3. Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
6. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

- 4.1 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 4.2 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 4.3 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 4.4 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 4.5 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;
- 4.6 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 4.7 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 4.8 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;
- 4.9 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 4.10 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative;
- 4.11 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative.

Naureda Llagami: Pa humbur kohë kalojmë në projekt-aktet e radhës të cilat kanë të bëjnë me hapjen e disa procedurave për lëvizjet paralele në tre gjykata, në Gjykatën e Elbasanit, në Gjykatën e Durrësit, në Gjykatën e Tiranës, në Gjykatën e Fierit dhe në Gjykatën Administrative të Tiranës. Ndërkohë kemi edhe hapjen e pozicioneve për në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe një pozicion në Gjykatën e Posaçme (çështjet vijuese në rend 6 dhe 7).

Shkurtimisht ia jap fjalën relatorit për t'i relatuar mbi nevojën e hapjes së këtyre pozicioneve dhe afatet e aplikimit.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Unë po paraqes relacionet e radhës.

Ne relacionet i kemi ndërtuar mbi bazën e niveleve të pozicioneve që hapim. Pra një relacion për të gjithë pozicionet që hapim për gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ. Një relacion që shoqëron projektvendimet për hapjen e vendeve të lira për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit dhe një relacion tjetër që shoqëron projektvendimin për hapjen e një pozicioni të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Pa humbur kohë po filloj me relacionin përkatës që i referohet hapjes së procedurës së lëvizjes paralele në gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm dhe atij administrativ.

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera ka përcaktuar Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ) si organin më të lartë përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin, si dhe në mënyrë të veçantë, ka parashikuar procedura të veçanta kur konstatojnë pozicione të lira, pas çdo kontrolli tremujor që kryen për këtë qëllim KLGJ. Kontrolli mbi pozicionet e lira të hapura i referohet rastit të lëvizjeve paralele, pra të shfrytëzimit të mekanizimit të lëvizjeve paralele dhe më konkretisht nenit 43 të ligjit “Për statusin..”.

Duke marrë në analizë sistemin së fundmi ne kemi analizuar sistemin dhe kemi vërejtur shpërpjesëtimin jo të drejtë të numrit të konflikteve gjyqësore dhe pakësimit të numrit të trupave gjyqësore, duke shkaktuar edhe një rritje të ngarkesës së trupës gjyqësore dhe duke dëmtuar në këtë mënyrë funksionalitetin e gjykatave specifikuisht të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan, me gjithë masat që Këshilli normalisht ka ndërmarrë, ku në korrik të vitit 2022 janë caktuar në pozicion 3 gjyqtarë në këtë gjykatë dhe në vitin 2023 u hap procedura e lëvizjes paralele për 6 pozicione të lira, të cilat janë përmbyllur me sukses. Gjithashtu u emëruan edhe 3 magjistratë të rinj. Pra nga viti 2022 deri aktualisht që ne po prezantojmë relacionin e radhës, ne kemi caktuar në pozicion gjithsej 12 magjistratë të rinj në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, pra i referohemi aktualisht Gjykatës së Elbasanit.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan referuar organikës së përditësuar të datës 22.04.2024 vijon si më poshtë:

Struktura Organizative: 18 gjyqtarë;

Organika në fakt: 18 gjyqtarë;

Efektivisht në detyrë: 12 gjyqtarë.

Nuk po lexoj strukturën përbërëse, gjyqtarët që janë efektivisht në detyrë, gjyqtarët që mund të kenë marrë lejen e lindjes, ata që janë të komanduar në Gjykatën e Lartë, të shkarkuar me vendim të KPK-së, por që procesi i tyre vijon në KPA.

Aktualisht, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka gjithsej 6 (gjashtë) pozicione të lira të përkohshme, por brenda 3 muajve, pritet që të bëhen vakanca të përhershme, vakancat e përkohshme pasi KPA është duke marrë në shqyrtim ankimet e regjistruara në vitin 2021.

Ngarkesa e gjykatës është sipas tabelave të mëposhtme në vijim. Unë nuk po i rendis një nga një, por mesatarja e ngarkesës së çështjeve në shqyrtim deri tani varion nga 300 (përveç {...}) deri në 600 që është gjyqtari me ngarkesën më të lartë.

Kjo është situata aktuale panoramike me një përshkrim të përmbledhur, pasi të gjitha të dhënat tona janë të pasqyruara në relacionin përkatës për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Referuar gjendjes aktuale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Aktualisht, situata në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës referuar organikës së përditësuar, vijon si më poshtë:

Struktura Organizative: 23 gjyqtarë;

Organika në fakt: 14 gjyqtarë;

Efektivisht në detyrë: 11 gjyqtarë.

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka gjithsej aktualisht 2 (dy) pozicione të lira të përhershme dhe 3 (tre) pozicione të lira të përkohshme. Kjo tabelë është përditësuar pas vendimeve që ne kemi nxjerrë si Këshill me nr. 146/2023, 215/2023 dhe 216/2023.

Në situatën aktuale të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, vlen të përmendim se 3 (tre) pozicione të lëvizjes paralele të hapura në 18.01.2023 janë ende në proces (kandidatë me 1 vlerësim; për 5 (pesë) pozicionet e reja të shpallura në 20.02.2024 ka përfunduar procedura e kualifikimit dhe vijon procedura e vlerësimit (3 pozicione kandidatë me 2 vlerësime dhe 2 pozicione në garë kandidatë me 1 vlerësim); gjithashtu në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës pritet të bëhet i lirë pozicioni i znj. {...} e cila pasi është dënuar me vendim penal të formës së prerë, me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të 09.04.2024 është vendosur “shkarkimi i saj nga detyra”; Gjithashtu në këtë gjykatë pritet që të krijohet vakancë për shkak të mbarimit të statusit të moshës për pension të 1 magjistrati (vakancë e cila do hapet për shkak se kjo vakancë është e llogaritur në aktet e parashikimit të kuotave për Shkollën e Magjistraturës për vitin 2021. Pra për vitin 2021 është parashikuar si vakancë e hapur për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës). KPA është duke shqyrtuar ankimet e regjistruara në vitin 2021, pra ka vakanca të përkohshme që mund të kthehen në vakanca të përhershme; Gjithashtu një magjistrat i caktuar përkohësisht ka zënë një pozicion të përhershëm (bëhet fjalë për z. {...} i cili kur është bërë transferimi i përkohshëm, është transferuar përkohësisht në një pozicion të përhershëm. Meqenëse ai aktualisht kandidon në një pozicion të përhershëm, ai në këtë rast nëse do fitojë si kandidaturë ai ka zënë një pozicion). Është edhe një situatë (e thashë) e pritshme për vitin 2021 që po shqyrton KPA-ja.

Më poshtë kemi paraqitur listën e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me ngarkesat e secilit gjyqtar në gjykatë.

Vijojmë me prezantimin e situatës aktuale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Aktualisht situata në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë referuar organikës së përditësuar, vijon si më poshtë:

Struktura Organizative: 80 gjyqtarë;

Organika në fakt: 68 gjyqtarë;

Efektivisht në detyrë: 52 gjyqtarë.

Bashkëlidhur është edhe tabela me numrin e gjyqtarëve, organikën si strukturë organizative, organikën në fakt dhe gjyqtarët që ushtrojnë efektivisht detyrën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Lidhur me ngarkesën e kësaj gjykate ne kemi parashtruar ngarkesën. Numri total i çështjeve të mbartura për këtë vit është 19.593; Numri i çështjeve të reja që kanë ardhur për gjykim nga data 1 janar është 11.162; Numri i çështjeve të gjykuara është 9.219 dhe numri i çështjeve në shqyrtim është 21.536.

Nga të dhënat e përcjella nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, vihet re ngarkesa në dhomën civile e cila varion nga 1.887 çështje në 116; ndërsa në dhomën penale është më e balancuar në ngarkesë, nga 367 në 16 çështje, duke marrë si ngarkesë mesatare për dhomën civile për çdo gjyqtar afërsisht 578, ndërsa spikat seksioni familjar që ka një ngarkesë mesatare prej 365 çështje/gjyqtar, ndërsa për dhomën penale numri mesatar i çështjeve në gjykim është 214.

Situata aktuale në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ku ne propozojmë hapjen e një vendi vakant për shkak të dorëheqjes së paraqitur nga magjistratja zonja {...}.

Struktura Organizative: 21 gjyqtarë;

Organika në fakt: 21 gjyqtarë;

Efektivisht në detyrë: 15 gjyqtarë.

Bashkëlidhur relacionit është edhe tabela ku gjen të pasqyruar gjyqtarët, organika në strukturë, organika në fakt dhe efektivisht sa gjyqtarë ushtrojnë detyrën aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Kalojmë tek situata në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë.

Sipas vendimit të Këshillit, organika e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është 27 (njëzet e shtatë) gjyqtarë. Aktualisht, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, referuar organikës së përditësuar, gjendja është si më poshtë

Struktura Organizative: 27 gjyqtarë;

Organika në fakt: 22 gjyqtarë;

Efektivisht në detyrë: 13 gjyqtarë.

Bashkëlidhur është tabela ku pasqyron organikën e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë ka gjithsej 5 (pesë) pozicione të lira të përhershme referuar strukturës organizative të saj, nga të cilat 3 (tre) pozicione janë të shpallura dhe për to vijon procedura e lëvizjes paralele; 9 (nëntë) pozicione të lira të përkohshme nga të cilat 3 (tre) për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar; 5 (pesë) për shkak të skemës së delegimit dhe 1 (një) për shkak të qenies anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Bashkëlidhur është paraqitur edhe tabela e cila pasqyron ngarkesën e çështjeve gjyqësore për çdo gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë.

Mekanizmat ligjorë për plotësimin e pozicioneve të lira të përhershme.

Me qëllim që të stabilizohet dhe të parandalohet dëmtimi i mëtejshëm i funksionalitetit të gjykatave duke përfshirë edhe efektet që rrjedhin nga aplikimi i Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe vazhdimi i krijimit të vakancave të tjera të përkohshme dhe të përhershme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka vlerësuar t’i propozojë Këshillit, mjetet efikase dhe ligjore që do të mund të stabilizojnë funksionalitetin, tashmë të dëmtuar të gjykatave që unë i prezantova më lart.

Në këtë kuadër, nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, është vlerësuar dhe do të propozohet një zgjidhje afatgjatë, që do të kërkojë disa kohë për përfundimin e këtij mekanizmi, pasi interferohet edhe me procedurat e vlerësimit të gjyqtarëve dhe nuk do të mund të konsiderohet si një mjet më efikas i stabilizimit të funksionalitetit të gjykatave. Sjell në vëmendjen tuaj parashikimet e nenit 43 të cilat trajtojnë procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve. Pra verifikim i kritereve formale, vlerësim, pastaj vijohet me procedurat e renditjes, përzgjedhjes dhe caktimin e tyre nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në pozicionet e hapura.

Qëllimi i nenit 43 është të garantojë zhvillimin e procesit të lëvizjes paralele, si një nga format e transferimit të magjistratit, duke parashikuar rregulla që adresojnë si nevojat e sistemit të drejtësisë, ashtu edhe të drejtën e magjistratit për ecurinë në karrierë. Bazuar në parimet e parashikuara në nenin 42, ligjvënësi ka synuar që nëpërmjet rregullave kryesisht procedurale në nenin 43 të ligjit “Për statusit”, të garantojë qartësi dhe parashikueshmëri për transferimin e magjistratit në procedurën e lëvizjes paralele, si një nga mjetet standarde të lëvizjes së gjyqtarëve brenda të njëjtit nivel.

Këshilli i Lartë Gjyqësor është i detyruar të vlerësojë, periodikisht ose rast pas rasti, nevojën për plotësimin e vendeve të lira në gjykata duke respektuar kushtet dhe parimet të parashikuara në nenin 42 të ligjit “Për statusit” lidhur me transferimin e magjistratit si dhe të rregullave të hollësishme që parashikon neni 43 për lëvizjen paralele. Gjithashtu magjistratët i nënshtrohen së pari renditjes së preferencës, parashikuar nga neni 42, pika 3 e Ligjit për Statusin dhe rregullave lejuese e ndaluese që parashikohen në nenin 43, me qëllim plotësimin e vendeve të lira sipas një renditje të caktuar që respekton parimet e sanksionuara në nenin 42.

Qëllimi i nenit 42 është të garantojë se procesi i transferimit të përkohshëm ose të përhershëm të magjistratit, në pozicione të ndryshme brenda të njëjtit nivel ose të barasvlershëm me të, të bëhet jo vetëm sipas nevojave të sistemit të drejtësisë, por edhe në respektim të funksionit dhe të zhvillimit të karrierës së magjistratit. Duke vendosur disa parime bazë, mbi të cilat kryhet transferimi, ligjvënësi synon së pari të disiplinojë këshillat në vendimmarrjen që lidhen me transferimin në pozicione të përhershme ose të përkohshme të magjistratëve sipas rregullave të parashikuara specifikisht dhe procedurave respektive. Së dyti, ai synon të ofrojë siguri, qartësi dhe parashikueshmëri për çdo magjistrat që mund t’i nënshtrohet procesit dhe procedurës të lëvizjes paralele.

Pika 3 e projektvendimit që ne propozojmë përcakton rrethanat dhe kategorinë e magjistratëve që caktohen në një pozicion të lirë të përhershëm, konkretisht:

- a) nga magjistrati që ka të drejtë të caktohet në nivel apeli;
- b) nga magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose kompetencën tokësore të gjykatave ose prokurorive.

Për plotësimin e pozicioneve të lira të përhershme Këshilli është i detyruar të respektojë radhën sipas shkronjave të mësipërme a); b); c) dhe ç) të këtij relacioni. Në kushtet kur Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/ Durrës/ Tiranë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë janë gjykata të shkallës së parë, procedura e ngritjes në detyrë në këto gjykata nuk mund të aplikohet. Pozicionet e lira të përhershme në këto gjykata mund të plotësohen si rregull vetëm nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele në rast se nuk ka magjistratë që do duhet të transferohen pranë këtyre gjykatave sipas parashikimeve të shkronjave a) dhe b) të përmendur më lart në kategoritë e cituara në këtë relacion. Pas verifikimeve të kryera, ka rezultuar se aktualisht, Këshilli nuk ka detyrimin ligjor për të transferuar gjyqtarë sipas germës a) dhe germës b), pra të drejtën e caktimit në nivel apel të gjyqtarit si dhe nuk ekzistojnë rastet e transferimit për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimit të strukturave administrative të gjykatave.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke marrë në konsideratë situatën e pasqyruar më lart, në të cilën ndodhen sot, Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan/ Durrës/ Tiranë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, si edhe për t'i paraprirë situatës në të cilën do të gjendet Këshilli në rastin e caktimit në pozicion të 32 (tridhjetë e dy) magjistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në muajin qershor të këtij viti, ne si Komisioni i propozojmë Këshillit të Lartë Gjyqësor të shpallë:

-hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për 1 (një) pozicion të lirë të përhershëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në fushën e së drejtës civile;

-hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për 4 (katër) pozicione të lira të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nga të cilat 3 (tre) në fushën e së drejtës civile dhe 1 (një) pozicion në fushën e së drejtës penale;

-hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për 3 pozicione të lira të përhershme në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nga të cilat 2 (dy) në fushën e së drejtës civile dhe 1 (një) pozicion në fushën e së drejtës penale;

-hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për 1 (një) pozicion të lirë të përhershëm

në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në fushën e së drejtës civile;

-hapjen e procedurës së lëvizjes paralele për 2 (dy) pozicione të lira të përhershme në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në përputhje me nenin 43 e vijues të ligjit “Për statusin” dhe vendimin nr.320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”.

Bashkëlidhur janë dhe të gjitha projektvendimet që shoqërojnë këtë relacion.

Së fundmi, meqenëse ne kemi lënë opsionale afatin e kandidimit pra deri në çfarë date do të duhet që kandidatët të paraqesin shprehjen e tyre të interesit, meqenëse ligji thotë jo më pak se dy javë, ne propozojmë afatin standard 2 javë, pra duke iu referuar ditës së sotme, data 2, ne propozojmë datën 16.05.2024 si dita e fundit e paraqitjes së kërkesave prej kandidatëve që do shprehin interesin për t’u përfshirë në procedurat e lëvizjeve paralele. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ndonjë diskutim?

Po!

Irena Plaku: Një diskutim në fakt, ka lidhje vetëm me Gjykatën e Tiranës, ku është propozuar pozicion, për një nga propozimet është bërë në fushën penale, të paktën sipas shkresës së bërë nga zëvendëskryetari i gjykatës, relaton faktin që ka të plotësuar me strukturë të plotë seksionin penal dhe nuk kërkon në seksion penal, por kërkon vetëm në seksionin civil dhe në ligj është përcaktuar që Këshilli merr mendimin gjithmonë të kryetarit të gjykatës lidhur me fushën ku do t’i përcaktojë vendet. Unë mendoj që duhet t’i shpallim të gjithë në fushën civile, për sa kohë që nevoja më e madhe është në këtë fushë. Edhe për faktin që ky propozim i imi vjen për faktin se kryetari i gjykatës ka të drejtë të përcaktojë seksionet dhe përveç atyre që ne kemi përcaktuar me vendim të Këshillit, janë edhe gjyqtarë të tjerë të cilët nuk janë caktuar me pozicione, që mund të kenë preferenca çdo dy vjet të ndryshojnë seksionin.

Këtë po them unë. Ata që do ndryshojnë pozicionin.

Kështu që i bie që kryetari i gjykatës më pas nuk mund të ketë...

Jo, jo, për ata që janë aktualisht në Gjykatën e Tiranës, që nuk kanë pas pozicione të përcaktuara më parë. Nuk po flas për këto që kemi caktuar ne, por për gjyqtarët të cilët nuk janë caktuar me vendim të Këshillit, por kanë qenë gjyqtarë efektiv në Gjykatën e Tiranës prej kohës. Dhe për sa kohë që kryetari i gjykatës, zëvendëskryetari në fakt, e ka përcaktuar në kërkesë që kërkon, thotë e ka të plotë (sepse po shikoja listën e gjyqtarëve të Gjykatës së Tiranës, atje në fakt të emëruar, pavarësisht se nuk janë në detyrë, ishin 24 më duket në Gjykatën e Tiranës, në fushën penale, ndërsa efektivisht ishin 21). Ka thënë, e kam të plotë. E dua në civile. Dhe më pas në civile, duke caktuar edhe në familjare, duke qenë se janë nevojat më të mëdha.

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Naureda Llagami: Hapni mikrofonat, sepse po flisni pa gjë.

Ju lutem hapini!

Klodian Kurushi: Jua thashë edhe një herë presionin e madh që vjen nga Shkolla e Magjistraturës, jo për ne por për është shkak të ligjit. Në qershor ne do të ndodhemi përpara një situatë që ku do t'i gjejmë vendet po s'morëm masat paraprakisht, e para. Edhe pastaj është pjesa e vlerësimit.

Mirë që na i vini në dukje këtë pjesën.

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Klodian Kurushi: Të vazhdoj edhe më tej?

Jo, jo, nuk ka lidhje me atë pjesën.

Më lër ta sqaroj edhe këtë pjesën tjetër, se unë e dëgjova. Edhe shqetësimin e zëvendëskryetarit e dëgjova.

Pjesa e dytë, ne kemi për detyrë, referuar nenit 43 të ligjit "Për statusin" që të parashikojmë edhe mundësinë brenda një tremujori se kur mund të hapen këto vende të lira. Dhe me parashikimet tona kemi menduar, kemi parashikuar që Gjykata e Durrësit, brenda tre muajve do t'i hapen katër vende sepse e thashë që janë disa situata që na

70

bëjnë, e thashë është 2021. Ne parashikime bëjmë dhe i bëjmë parashikimet sepse na e lejon ta bëjë ligji por edhe nevoja e sistemit se do vijë magistratët. Nëse nuk lëvizim sot... Tani, kjo është pjesa e Durrësit.

Në lidhje me Tiranën, pse kemi propozuar në tre vende, dy plus një?

Kemi marrë statistikën e fundit të Gjykatës së Tiranës, duke iu referuar edhe vlerësimit që ka bërë KPA-ja në lidhje me një gjyqtar i cili ka qenë aktualisht në Gjykatën e Tiranës, seksioni penal. Vendi i tij aktualisht sot është i lirë dhe ai vend ka qenë pozicion konkret në seksionin penal të Gjykatës së Tiranës. Tani, me të vërtetë kryetari e ka ngritur këtë shqetësim.

Ne kur kemi bërë parashikimet e kemi bërë për vendet konkrete ku janë të hapura dhe ku ka mundësi të hapen brenda afatit tremujor dhe aktualisht nuk mund të mos ta merrim në konsideratë faktin që një gjyqtar është shkarkuar me vendim të formës së prerë dhe të themi jo, se si vend e llogarisim ne atë të hapur, por tani duhet të diskutojmë pozicionin. Dhe me të drejtë kryetari i gjykatës në detyrë thotë, shiko ne kemi problem më tepër në civile. Dakord. Nuk është se nuk kemi marrë masa për civilen deri tani aktualisht. Vazhdojmë të kemi marrë masa edhe në civile, dhe raporti i fundit fare ka qenë 9 me 2.

Por duhet t'ju bëj të ditur kolegëve edhe diçka tjetër. Kur ne kemi caktuar gjyqtarë në fushën civile, ka qenë po kryetari i cili me vendim përkatës ka bërë lëvizjet sipas nevojave që ka gjykata. Po pra ka gjyqtarë aktualisht që janë në seksionin penal, që i ka caktuar me vendim të Këshillit, por që me vendim të KLGJ-së nuk na rezultojnë të jenë në dhomën penale, por duhet të jenë në seksionin civil. Dhe këtë e ka bërë kryetari. Për nevoja, kryetari nesër mund t'i marrë dhe të respektojë vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ato që ne i kemi caktuar definitivisht në pozicionet civile, t'i kthejë në pozicionet civile. Dakord? Kjo ka qenë arsyeja pse i kemi marrë pjesërisht në konsideratë.

Naureda Llagami: Nuk po ia heqim kompetencat kryetarit.

Nuk po ia heqim as kryetarit, as Këshillit.

Po edhe ato ia kanë hequr kur ka ardhur koha, momenti i KLGJ-së.

Ajo që themi, kjo situatë është tranzitore, pra edhe ne e kemi mirëkuptuar kur ai për shkak nevojë i ka kaluar, dhe ai do na mirëkuptojë që edhe ne për shkak të pozicioneve që kemi, propozojmë këtë. Kur të vijë puna atje në gjykatë, ai të vlerësojë sepse ai është më në kontakt me nevojën dhe ai e bën.

A kemi probleme mbi numrin?

Ti mendon që ka probleme te numri? – Jo!

Tek pjesa e kësaj, komisioni e sheh në pjesën ku e ka nevojën.

Ai le t'i ndryshojë po të dojë, siç i ka ndryshuar gjithmonë.

Irena Plaku: Ajo që thashë unë në fakt është që mos të kemi këto situata që ndryshojnë.

Naureda Llagami: Ka për të qenë se është dinamike situata. Ikën njëri, ngrihet në pozicion.

Irena Plaku: Patjetër që është dinamike.

Ne nuk i kemi çuar me emra. Asnjëherë nuk e kemi bërë.

Naureda Llagami: Edhe ky Këshill kështu do të merret.

Ai ka folur me pozicione në fakt, që ka ngelur një pozicion në penale. Jo me emër. Ne ta thamë emrin këtu midis nesh. Por ajo që është shumë e rëndësishme sot është që ky Këshill vazhdon të flasi me këtë lloj gjuhe, sepse do të vijë një moment një Këshill tjetër i cili, do të jenë pozicionet e mbuluara dhe nuk do të kemi më, një që do shkojë atje. Tani jemi në këtë situatë që bëjmë lëvizje që të kemi... Sa më shumë bëjmë lëvizje aq më mirë është. Edhe pozicionin e kemi diskutuar njëqind herë.

Klodian Kurushi: Edhe shqetësimin e kryetarit në detyrë, vazhdoj ta them, e kemi marrë në konsideratë, në të gjitha situatat kur kemi hapur pozicione për lëvizje paralele, fokusi ka qenë seksioni civil.

Gjithë kohës ia kemi marrë mendimin.

Alban Toro: Irena, ku e ke të përcaktuar në ligj që duhet t'i marrësh... mendimi i tij është deçiziv? Shiko 89 e qeverisjes, të ngarkon që ti të ruash ngarkesën njësoj të gjyqtarëve. Çfarë ka bërë kryetari me ngarkesën? I mori nga civilja, i çoi në penale. Kjo është.

Po këta që ikin rrugës? Do parashikosh edhe për këta që ikin rrugës. Do të kapërcejnë dy në apel.

Klodian Kurushi: Duhet ta them, edhe shqetësimi i kryetarit gjendet i pasqyruar, jo vetëm në këtë relacion por në vijimësi Këshilli fokusin e ka pasur tek seksioni civil, edhe vendet e fundit që ne shpresojmë që t'i mbyllim sa më shpejt, të rregullojmë po themi atë mbingarkesë që ka seksioni civil, shpresojmë ta mbyllim, i kemi po në fokusin civil. Tani raporti është po 2:1. Vazhdojmë ta quajmë si prioritare mbushjen e pozicioneve civile me gjyqtarët që duhet të vijmë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele. Kështu që edhe shqetësimi i kryetarit gjen pasqyrim tek relacioni dhe tek propozimet që ne i bëjmë Këshillit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Diskutim tjetër?

(Nuk ka diskutime të tjera.)

Nëse jo, kalojmë në votim të projekt-aktit.

Pra gjithë logjika është që do të ecim me këtë, por me afatin e kandidimit deri më datë 16.05.2024.

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit. Fillojmë fillimisht me Gjykatën e Elbasanit, sipas radhës që na kanë ardhur. Një pozicion për lëvizje paralele, një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile. Afati i kandidimit deri më datë 16.05.2024, në Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet.

Naureda Llagami: Kalojmë në Gjykatën e Durrësit (shkalla e parë). Tre pozicione në fushën e së drejtës civile dhe një pozicion në fushën e së drejtës penale. Afati i kandidimit 16 maj.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet).

Naureda Llagami: Kalojmë në Gjykatën e Tiranës (shkallës së parë Tiranë). Dy pozicione në fushën e së drejtës civile, një pozicion në fushën e së drejtës penale. Njësoj afati i kandidimit 16.05.2024.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet.

Naureda Llagami: Kalojmë në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier. Një pozicion në fushën e së drejtës civile.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet.)

Naureda Llagami: Kalojmë hapjen e dy pozicioneve për lëvizje paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, po me të njëjtin afat kandidimi, 16.05.2024.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet.)

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.05.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):⁴

5.1 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

5.2 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

5.3 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 14:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |

⁴ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 6 sipas rendit të ditës.

6. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
6. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi):

5.1 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

5.2 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

5.3 Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës. Sërisht e ka fjalën për hapjen e pozicioneve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën e Posaçme (*çështje e radhës*).

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Atëherë, në mënyrë të përmbledhur po prezantoj relacionin që i bashkëngjitet projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës civile”.

Sipas vendimit të Këshillit nr. 505, datë 21.11.2022, struktura organizative e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është 78 gjyqtarë.

Aktualisht në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm referuar organikës së përditësuar më datë 24.04.2024, vijon si më poshtë:

Struktura Organizative: 78 gjyqtarë;

Organika në fakt: 32 gjyqtarë;

Efektivisht në detyrë: 26 gjyqtarë;

Bashkëlidhur është edhe tabela përkatëse e cila pasqyron strukturën organizative të gjykatës, organikën në fakt dhe numrin efektivisht në detyrë të gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Sa më sipër Gjykata e Apelit referuar organikës së prezantuar sipas tabelës të integruar në këtë relacion, rezulton se Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka gjithsej 46 (dyzet e gjashtë) pozicione të lira të përhershme dhe 6 (gjashtë) të përkohshme (duke përfshirë këtu edhe anëtarët e KLGJ-së që janë z. Hado dhe znj. Muçi).

Këshilli i Lartë Gjyqësor, nga krijimi i tij deri më sot ka përfunduar me sukses procesin e ngritjes në detyrë për 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë në Gjykatat e Apelit (këtu përfshijmë Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës, Vlorë, Korçë, tashmë që janë pjesë e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm). Në këtë proces janë gjithsej 12 pozicione të lira të shpallura më herët nga Këshilli, pozicionet 502 deri në 504, pra tre pozicione në fushën e së drejtës penale të shpallura në nëntor 2022.

Në pozicionin 502 vijon procedura e vlerësimit të kandidatëve; në pozicionin nr. 503 vijon procedura e vlerësimit të kandidatëve, gjithashtu një kandidat gjendet në procesin e rivlerësimit kalimtar përpara KPA-së; ndërsa në pozicionin 504 vijon procedura e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve si edhe për një kandidat vijon procesi i kualifikimit në Këshill.

Pozicionet 239-247 i përkasin fushës civile dhe janë shpallur në maj 2023. Për këto pozicione procedura e verifikimit ka filluar në shkurt të vitit 2024 dhe kandidatët janë kualifikuar dhe vijon procedura e vlerësimit etik dhe profesional të tyre.

Nisur nga sa sipër, mund të mendohet se në një kohë jo të largët, Gjykata e Apelit Juridiksionit të Përgjithshëm do të plotësohet edhe me 12 (dymbëdhjetë) gjyqtarë të tjerë, duke arritur kështu numri i gjyqtarëve të saj në detyrë në 38 (tridhjetë e tetë), ende më pak se 50% e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve.

Pozicionet aktualisht të lira në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nevoja për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë

Siç u parashtrua, aktualisht në Gjykatën e Apelit Tiranë e Juridiksionit të Përgjithshëm ka gjithsej 46 (dyzet e gjashtë) pozicione të lira të përhershme, ku për plotësimin e 12 (dymbëdhjetë) prej të cilave janë në proces procedurat përkatëse të ngritjes në detyrë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, sikurse u tha dhe më lart, vlerëson se ato duhet të plotësohen përmes procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve.

Mekanizimi i transferimit të gjyqtarëve nëpërmjet lëvizjes paralele, i parashikuar në germën “ç” të paragrafit 2 neni 43 të Ligjit për Statusin, nuk është i mundur të aplikohet, pasi nuk ka gjyqtarë të cilët plotësojnë kriteret sipas parashikimit të mësipërm ligjor.

Siç rezulton nga statistikat e përcjella nga gjykata respektive, nevoja për gjyqtarë në këtë gjykatë është e madhe, por kjo nevojë duhet të jetë përpjesëtimore me mundësinë e Këshillit për të përfunduar në kohë procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, në kushtet kur ka tashmë në proces 12 procedura, 3 prej tyre të vitit 2022 dhe 9 prej të cilave në vitin 2023.

Ngarkesën e keni të përfshirë në relacion dhe nuk po ndalem (ngarkesën për secilin gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm).

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, mbajtur në vëmendje: i) situatën aktuale dhe atë të pritshmërive në këtë gjykatë; ii) numrit të lartë të çështjeve që ka kjo gjykatë; iii) stokun e çështjeve; iv) kohëzgjatjen e procedurave të ngritjes në detyrë, vlerëson se fillimi aktualisht i 3 (tre) procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e të drejtës civile, do të mundësonte plotësimin e 3 (tre) pozicioneve të lira në një kohë më të shpejtë, duke rritur në këtë mënyrë funksionalitetin e saj, ndërkohë që stoku i çështjeve për gjykim përpara kësaj gjykate aktualisht, deri më datë 24.04.2024, është 38.098 çështje, e tillë që dëmton të drejtën e gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm. Ngarkesa siç rezulton edhe nga tabela e mësipërme është e konsiderueshme në seksionin civil nga 2.251 çështje/gjyqtar, në 1.888 çështje/gjyqtar.

Bashkëlidhur relacionit është edhe projektvendimi përkatës që shoqëron relacionin. Janë tre projektvendime përkatëse që shoqërojnë relacionin për hapjen e tre vendeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në fushën e të drejtës civile. Edhe në këtë rast, siç proceduam tek propozimet që bëmë për hapjen e pozicioneve të lira në gjykatat e shkallës së parë nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ne propozojmë që afati i dorëzimit të kërkesave të kandidatëve së bashku me dokumentacionin të jetë data 16 maj 2024, që është ditë e enjte, sot dy javë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse s'kemi diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga kryetari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ku propozohet hapja e tre pozicioneve në ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, në fushën e të drejtës civile, me afat kadidimi deri më datë 16.05.2024. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.05.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).⁵

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 14:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |

⁵ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 7 sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Valbona Bala, eksperte pranë EWMI/INL.*
6. *Arben Lila, përfaqësues i Projektit EU4Justice.*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës, që edhe kjo ka të bëjë me hapjen e një procedure të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për një pozicion të lirë në këtë gjykatë. Fjalën e ka z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zonja Kryetare!

Sipas nenit 15, pika 4, e Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përbëhet nga së paku 16 gjyqtarë, çka është e përfshirë ky

përcaktim edhe në vendimin nr. 286, datë 18.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përputhje me kompetencën e tij të përcaktuar në nenin 22 të këtij ligji.

Aktualisht, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ushtrojnë detyrën 9 (nëntë) gjyqtarë me caktim të përhershëm. Pra, aktualisht, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka gjithsej 7 (shtatë) pozicione të lira (pra 9 janë në detyrë, 7 janë të lira, sepse totali është 16 gjyqtarë). Tre pozicione (përkatësisht 499, 500 dhe 501) janë shpallur të lira në nëntor 2022 dhe për to vijon procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës nga komisioni i posaçëm i ngritur pranë këtyre strukturave të posaçme.

Procedura për këto pozicione vijon. E përmenda edhe më lart.

Në këto tre pozicione, në njërin prej tyre janë vetëm 2 kandidatë për të cilët edhe procesi i vlerësimit etik dhe profesional është në përfundim; në 1 pozicion (500) gjendet veç të tjerëve edhe një kandidat për të cilin është kërkuar përsheptimi i procedurës nga ana jonë, pra nga ana e Këshillit, përpara KPA-së; ndërsa në një pozicion tjetër gjenden kandidatë në pritje të vlerësimeve dhe procesit të verifikimit të figurës dhe pasurisë.

Ndërmjet të tjerave, për zotin {...} gjyqtar i ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda vijon procesi gjyqësor, pasi Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 49/2023, vendosi:

1. Pranimin e padisë që i përket paditësit {...}.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 110, datë 13.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Detyrimin e palës së paditur Këshilli i Lartë Gjyqësor që të caktojë paditësin {...} në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në mënyrë hipotetike, Këshilli mund të gjendet në një situatë pas procesit të rivlerësimit në KPA për gjyqtarin e ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, z. {...}. Pra mund të presim edhe një vendimmarrje, ndoshta të ngjashme me atë të z. {...}. Ndodhur në këto kushte, dy pozicione janë lënë të tilla që të presin vendimmarrjet e institucioneve të tjera.

Aktualisht, struktura në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, paraqitet si më poshtë:

Struktura Organizative: 16 gjyqtarë;

Organika në fakt: 9 gjyqtarë;

Efektivisht në detyrë: 9 gjyqtarë.

Propozimi i Komisionit:

Nga kjo gjykatë janë paraqitur për periudhën janar 2023 e në vijim këto të dhëna lidhur me kërkesat për caktim gjyqtari në çështje të veçanta në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksione në mënyrë të përhershme.

Për vitin 2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka përcjellë 18 kërkesa për caktim gjyqtari, në përgjigje të të cilave janë caktuar 24 gjyqtarë.

Për periudhën janar-prill 2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka përcjellë 13 kërkesa për caktim gjyqtari, në përgjigje të të cilave janë caktuar 23 gjyqtarë.

Informacioni është përfshirë në tabelën përkatëse dhe pjesë integrale e relacionit që unë po prezantoj dhe nuk po ndalem me ngarkesën e secilit gjyqtar që ka aktualisht në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Vlerësuar rëndësinë e madhe që ka plotësimi i vendeve vakant të përhershme pranë kësaj gjykate, mbajtur në vëmendje që pozicionet e lira në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mund të plotësohen vetëm përmes ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe i propozon Këshillit projektvendimin për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për 1 (një) pozicion të lirë.

Ky është propozimi ynë. Struktura e projektvendimit, nuk po e lexoj, është bashkëlidhur relacionit përkatës.

Edhe në këtë rast afati si ditë e fundit e paraqitjes së kërkesave për kandidatët ne propozojmë të jetë data 16.05.2024. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse s'kemi diskutime, e hedhim në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë Këshilli vendosi hapjen e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për një pozicion të lirë, me afat datë 16 maj 2024.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.05.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.⁶

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 14:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |

⁶ Kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e 4 sipas rendit të ditës.

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër. Bëhet fjalë për Gjykatën e Dibrës, për caktimin e gjyqtarit për median.

Duke qenë se gjyqtari përkatës që ka qenë në këtë gjykatë, ka lëvizur, nuk është më gjyqtar i kësaj gjykate, atëherë kjo gjykatë na ka sjellë një propozim për një gjyqtar tjetër për median. Pra ka qenë zonja {...} në cilësinë e gjyqtarit për median dhe kryetari i gjykatës ka propozuar një gjyqtare tjetër, konkretisht gjyqtaren {...}.

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit për kandidaten *znj. {...}*, si gjyqtare e medias në Gjykatën e Shkallës së Parë Dibër.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi ndryshimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të pikës 1, nr. nr. 280/2019 “Për caktimin e Gjyqtarëve për Mediat”, i ndryshuar, në bazë të të cilit gjyqtari për mediat në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, znj. {...} zëvendësohet në detyrë nga gjyqtarja {...}.

Ngarkohet gjyqtari për mediat i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër të marrë masat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.05.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 07.02.2024, 07.02.2024 (ora 15:30), 15.02.2024, 20.02.2024, 23.02.2024 dhe 29.02.2024.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 14:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 3. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Irena Plaku | (anëtare) |
| 6. Gentiana Muçaj | (anëtare) |
| 7. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Markelian Koça | (anëtar) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Maela Alicantaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
4. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
5. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, të datave: 07.02.2024, 07.02.2024 (ora 15:30), 15.02.2024, 20.02.2024, 23.02.2024 dhe 29.02.2024.

Naureda Llagami: Kalojmë edhe tek akti i fundit që ka të bëjë me miratimin e disa procesverbaleve të Këshillit. Ato janë vënë në dispozicion.

Atëherë kalojmë tek miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve konkretisht të të datave 7 shkurt, 15 shkurt, 20 shkurt, 23 shkurt dhe 29 shkurt.

Në fakt i bëj thirrje për këto procesverbalet të ecim pak më shpejt se jemi akoma te shkurti. E di ngarkesën.

Kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet projekt-akti.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.05.2024)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së z. {...} “Për përjashtimin e relatorit dhe të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nga procedurat për të cilat ai ka kandiduar për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...} “Për përjashtimin e relatores znj. Irena Plaku nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën 2017-2019””.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 14:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi*** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Gentiana Muçaj*** (anëtare)

94

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 02.05.2024 (Pika 9 dhe 10)***

7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Markelian Koça* (anëtar)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së z. {...} “Për përjashtimin e relatorit dhe të anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, nga procedurat për të cilat ai ka kandiduar për lëvizje paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për pranimin/refuzimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...} “Për përjashtimin e relatores *znj. Irena Plaku* nga procedura e vlerësimit etik dhe profesional, për periudhën 2017-2019””.

Naureda Llagami: Përpara se të kalojmë tek caktimi i gjyqtarëve në gjykatat në nevojë, ju e dini shumë mirë që kishim parashikuar në rendin e ditës edhe dy çështje që kishin të bënin me kërkesat për përjashtimin relatorëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Por

për shkak të kuorumit, mungesës së kuorumit që kemi, këto çështje mund të shqyrtohen nesër nga Këshilli ose në ditët në vijim, javës tjetër.

* * *

(Pika 9 dhe 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.05.2024)

Pika 11 shtesë e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:08 dhe mbaroi në orën 14:35.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Markelian Koça*** (anëtar)
10. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

97

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 02.05.2024 (Pika 11 shtesë)***

Shënim 1: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Emona Muçi*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Rezarta Taushani, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Maela Alicanaj Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
5. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

11 Shtesë. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarit për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Kurushi).

Naureda Llagami: Kemi tani kërkesën për caktim. Do e relatojë z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Çështja e radhës ka për objekt caktimin e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Deri më datë 02.05.2024, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, të Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Natyra e çështjes është penale. (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Kërkohej caktimi i 1 (një) gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues për gjykimin e çështjes penale të themelit me të pandehur {...}, {...} etj. Me vendim të KLGJ-së është caktuar për këtë çështje trup gjykues i përbërë nga {...}, {...} dhe {...}; Me vendimin nr. 242, datë 23.04.2024 Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

98

Organizuar ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me objekt: “Përjashtimin e gjyqtares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës znj. {...} nga gjykimi i çështjes penale.

Kanë pengesë gjyqtarët {...} dhe {...} pasi kanë kryer veprime paraprake për procedimin penal në ngarkim të të pandehurve {...} etj.

Trupi gjykues i përbërë nga {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin nr. {...}, datë 11.04.2023, në ngarkim të të pandehurit në procedim të lidhur {...}.

Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: {...}, {...} dhe {...} kanë në gjykim aktualisht dosjen penale në ngarkim të të pandehurve {...} etj., që ka ardhur për gjykim në seancë paraprake me nr. {...} regjistrimi, datë 09.08.2023 në ngarkim të të pandehurit {...} etj.

Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin nr. {...}, datë 10.11.2023 në ngarkim të të pandehurve {...} dhe {...} etj.

Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë aktualisht në gjykim dosjen penale nr. {...}, datë 08.03.2024 në ngarkim të të pandehurit {...}, si procedim i lidhur me çështjen në ngarkim të të pandehurit {...}.

Në skemën e delegimit janë aktualisht 5 (pesë) gjyqtarë konkretisht: z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...} caktuar për të gjykuar për llogari të gjykatës administrative të apelit.

E bëj këtë parashtesë sepse dua të them arsyet pse propozoj këtë mekanizëm.

Zbatimi i mekanizmit të skemës së delegimit të gjyqtarit dhe zbatimi i mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit bëhen të pamundur për t’u aplikuar në këtë rast konkret.

Ndodhur në këto kushte, ne si komision i propozojmë Këshillit të vihet në zbatim mekanizmi i caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Propozimi mbështetet në paragrafin X/2 të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

1. Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

2. Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016.

3. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një) sepse është një numër që plotëson treshen e trupit gjykues që ka në gjykim çështjen penale të përmendur më lart.

Në opsionin e pranimit të propozimit si më lart, për hapat e shortit që duhet të ndiqen, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon: Për 1 (një) çështje, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, të përzgjidhet me short 1 i tillë, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret e përmendura më lart.

Referuar paragrafit VIII të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit më sipër.

Gjithashtu edhe gjyqtarët e shortuar së fundmi dhe që kanë ngarkesë: znj. {...}, znj. {...}.

Njëkohësisht unë propozoj që në këtë rast të përjashtohen gjyqtarët z. {...} si dhe gjyqtarja znj. {...}, si gjyqtarë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të përjashtohen nga pjesëmarrja e tyre në numrin e gjyqtarëve që do të gjykojnë këtë çështje gjyqësore.

Jeni dakord me këto propozime të përjashtohen përveç atyre edhe dy kolegët e tjerë?

Naureda Llagami: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Naureda Llagami: Të vijohet me hedhjen e shortit.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Vijohet me hedhjen e shortit elektronik, duke u bërë përditësimi i listës.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën 1606, gjyqtar i përzgjedhur z. Taulant Banushi.

Naureda Llagami: Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot.

Ju uroj punë të mbarë.

* * *

(Pika 11 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor